

VËLLIMI X XIII / PRILL – QERSHOR / 2023

VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS

BULETINI ZYRTAR

PËRMBAJTJA

Nr. 971, Datë 07. 04. 2023.....	5
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TE PLOTA, NGA SHOQËRITË EAGLE HILLS REAL ESTATE DEVELOPMENT SHPK DHE ALBANIAN SEAPORTS DEVELOPMENT COMPANY SHA ”	
Nr. 972, Datë 07. 04. 2023.....	10
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË NJËSISË SË BIZNESIT “MOBILITY SERVICE PLATFORM” NGA SHOQËRIA CARIAD SE”	
Nr. 973, Datë 07. 04. 2023.....	13
“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË KUTOAVE TË SHOQËRISË KHIDRAT RENEWABLE ENERGY PRIVATE LIMITED NGA SHOQËRIA SOURYA MANTHAN RENEWABLE ENERGY PRIVATE LIMITED”.	
Nr. 974, Datë 14. 04. 2023.....	17
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË NIRA DYNAMICS AB NGA SHOQËRIA CARIAD SE”	
Nr. 975, Datë 14.04.2023.....	20
“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJEVE AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, DEVI 20 - GRUP SHPK, EQEREM-934 SHPK, FERRA & CO SHPK, GLOBCOM SHPK, KRIKET-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK DHE PDF SHPK NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË VAJIT VEGJETAL”	
Nr. 976, Datë 14.04.2023.....	26
“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit”	
Nr. 977, Datë 26. 04. 2023.....	32
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË METRO FARMACI SHPK NGA SHOQËRIA DELTA HOLDING SHPK”	
Nr. 978, Datë 26. 04. 2023.....	35
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË AVICENA SHPK NGA SHOQËRIA DELTA HOLDING SHPK”	

Nr. 979, Datë 26. 04. 2023.....	38
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DELTA PHARMA – AL SHPK NGA SHOQËRIA DELTA HOLDING SHPK”	
Nr. 980, Datë 26. 04.2023.....	41
“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 961, datë 28.02.2023, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit”	
Nr. 981, Datë 11. 05. 2023.....	43
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË SAUDI ARAMCO DEVELOPMENT CO LTD. DHE EXCEL INVESTMENTS NETHERLANDS B.V.”	
Nr. 982, Datë 11. 05. 2023.....	46
“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË ASETIVE TË SHOQËRISË BREEZE TWO ENERGY GMBH & CO.KG, NGA SHOQËRIA STATKRAFT GERMANY GMBH”	
Nr. 983, Datë 11. 05. 2023.....	49
“PËR PËRJASHTIMIN NGA NDALIMI TË MARRËVESHJES SË LIDHUR NDËRMJET SHOQËRIVE PHILIP MORRIS PRODUCTS S.A DHE KT&G CORPORATION”	
Nr. 984, Datë 11.05.2023.....	55
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ NDËRMARRJES TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK NË TREGUN E SHËRBIMIT TAKSI PËR UDHËTARË NGA DHE DREJT AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS	
Nr. 985, Datë 24. 05. 2023.....	57
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË SHANGHAI MUCHUAN INDUSTRIAL DESIGN CO., LTD NGA SHOQËRIA CARIAD ESTONIA AS.”	
Nr. 986, Datë 24. 05. 2023.....	61
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE PEEL NRE WIND FARMS (YELL) LIMITED DHE PEEL NRE WIND FARMS (NO.1) LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT UK LTD”	

Nr. 987, Datë 24.05.2023.....	65
“PËR MARRJEN E MASËS SË PËRKOHSHME PËR RIVENDOSJEN E KONKURRENCËS NË TREGUN E SHËRBIMIT TAKSI PËR UDHËTARË NGA DHE DREJT AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”	
Nr. 988, Datë 24. 05. 2023.....	67
“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË GRUPPO ZAFFIRO S.R.L. NGA SHOQËRITË EURIZON CAPITAL REAL ASSET S.G.R S.P.A. DHE SARAFIN S.P.A.”	
Nr. 989, Datë 08. 06.2023.....	71
“Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 874, datë 25.03.2022”	
Nr. 990, Datë 08.06.2023.....	74
“MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT “MBI UDHËZIMET JOZYRTARE PËR SA I PËRKET ÇËSHTJEVE TË REJA OSE TË PAZGJIDHURA NË LIDHJE ME NENET 4 DHE 9 TË LIGJIT NR. 9121/2003 “PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS” PËR RASTE INDIVIDUALE””	
Nr. 991, Datë 08. 06. 2023.....	76
“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE EÓLICA CQN UNO SPA DHE EÓLICA CQN DOS SPA NGA SHOQËRIA EMPRESA ELÉCTRICA PILMAIQUÉN S.A.”	
Nr. 992, Datë 08. 06. 2023.....	79
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BASHKIMIT ME PËRTHITHJE TË SHOQËRISË GEGA OIL SHA NGA SHOQËRIA GENKLAUDIS SHA”	
Nr. 993, Datë 08. 06. 2023.....	82
“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË GEGA OIL GROUP SHA, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BASHKIMIT ME PËRTHITHJE TË SHOQËRISË GEGA OIL SHA NGA SHOQËRIA GENKLAUDIS SHA”	

VENDIM

Nr. 971, Datë 07. 04. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TE PLOTA, NGA SHOQËRITË EAGLE HILLS REAL ESTATE DEVELOPMENT SHPK DHE ALBANIAN SEAPORTS DEVELOPMENT COMPANY SHA ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07. 04. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Në zbatim të pikës II të Vendimit të Komisionit të Konkurrencë nr. 917, datë 24.10.2022 “Mbi disa rekomandime në lidhje me draft marrëveshjen kuadër për projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit” dhe marrëveshjeve të tjera të dakortësuara ndërmjet Komitetit të Negociimit të Marrëveshjeve dhe Subjektit Investues, Eagle Hills Real Estate Development SHPK”, pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, me funksione te plota, nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA.

Referuar dokumentit “Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë Durrës-Marina SHA”, të nënshkruar më datë 30 janar 2023, palët janë:

Pala 1: Shoqëria Albanian Seaports Development Company SHA (ASDC) është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: koordinimin, administrimin e proceseve të lidhura me projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”; administrimin e pasurive dhe shërbimeve jashtë terminaleve në përdorim të Autoritetit Portual Durrës, si dhe çdo pronë/pasuri që mund t’i kalohet në pronësi; përkujdesjen dhe zbatimin e rregullave të administrimit përsa i përket territoreve dhe ambienteve të Autoritetit Portual të Durrësit etj.

Kjo shoqëri kontrollohet 100% nga Autoriteti Portual i Durrësit, autoritet publik i cili kujdeset për shërbimet dhe kushtet e hyrje-daljes së mjeteve lundruese, si dhe për sigurinë e turistëve në hapësirën portuale, duke siguruar menaxhim eficient për komunitetin e transportit, për klientët portualë, përdorimin e faciliteteve të portit, duke ofruar shërbim cilësor e të besueshëm për kalimin e mallrave nga transporti detar në atë rrugor, hekurudhor me çmime konkurruese dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të ruajtjes së mjedisit.

Pala 2. Shoqëria Eagle Hills Real Estate Development SHPK (Eagle Hills) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: zhvillimin dhe ndërtimin e pasurive të paluajtshme, dhënie me qera të pasurive të paluajtshme dhe çdo aktivitet tjetër në lidhje me pasuritë e paluajtshme.

Eagle Hills Real Estate SHPK kontrollohet 100% nga North East Real Estate Holdings Limited, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas Ligjeve të Abu Dhabi dhe kjo e fundit nga shoqëria Symphony Global Holdings Limited, themeluar në Emiratet e Bashkuara Arabe.

Referuar akteve të themelimit të shoqërive dhe bazuar në Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 3.2. “E drejta e vetos”, Z. Mohamed Ali Rashed Alabbar ka kontrollin indirekt mbi shoqërinë Eagle Hills Real Estate Development SHPK.

Shoqëria e përbashkët (JV): Durrës Marina SHA do të jetë një shoqëri aksionare me ofertë private. Shoqëria fillon veprimtarinë e saj në datën e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit, në varësi të përmbushjes së kërkesave të themelimit. Qëllimi i vetëm i shoqërisë është të ushtrojë biznesin, që nënkupton zhvillimin e një resorti të pasurive të paluajtshme për përdorime të ndryshme si edhe të marinës në Territorin e Projektit, në përputhje me Master Planin dhe Master Planin e Marinës, si dhe operimin dhe menaxhimin e veprimtarive të ndryshme të biznesit në pajtim me Planin e Biznesit dhe Planin e Biznesit për Marinën.

II. Përqendrimi

Më datë 30 janar 2023, është nënshkruar “Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë Durrës Marina SHA”, ndërmjet shoqërive Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA.

Referuar këtij dokumenti palët bien dakord të themelojnë bashkërisht një shoqëri aksionare me ofertë private, për qëllimet dhe për objektin e parashikuar në Statut. Objekti i shoqërisë është “të ushtrojë Biznesin, i cili nënkupton zhvillimin e një niveli të klasit botëror të një resorti të pasurive të paluajtshme për përdorime të ndryshme si edhe të marinës në Territorin e Projektit, në përputhje me Master Planin dhe Master Planin e Marinës si dhe operimin dhe menaxhimin e veprimtarive të ndryshme të biznesit në përputhje me Planin e Biznesit dhe Planin e Biznesit për Marinën”.

Eagle Hills dhe ASDC, do të jenë aksionarët e shoqërisë Durrës Marina SHA. Mbledhja e Asamblesë,

është autoriteti më i lartë vendimmarrës i shoqërisë. Në përgjithësi, të gjitha vendimet e Mbledhjes së Asamblesë miratohen me 50%+1 të votave në Mbledhjen e Asamblesë. Vetëm vendimet e rëndësishme si: miratimi ose ndryshimi i buxhetit, miratimi ose ndryshimi i Master Planit, rritja ose zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë, emërimi dhe largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës etj, duhet të marrin pëlqimin e 75% të votave me të drejtë votimi.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria Durrës Marina SHA do të zotërohet 67% nga Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe 33% nga Albanian Seaports Development Company SHA.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në themelimin e një shoqërie të përbashkët, nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA, i cili përbën një përqendrim objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës, në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Me ligjin nr.79, datë 24.11.2022 “Për miratimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company SHA, dhe NSHMI Development L.L.C., në lidhje me projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”, është miratuar Marrëveshja Kuadër dhe gjithë marrëveshjet e tjera për zbatimin e projektit strategjik.

Marrëveshja Kuadër e lidhur ndërmjet palëve: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company SHA dhe NSHMI Development SHPK (në rolin e garantuesit), ka për qëllim të rregullojë dhe të përcaktojë marrëdhëniet nëpërmjet palëve në lidhje me zbatimin e Projektit, ofrimin e Shërbimeve, funksionimin e Investitorit Strategjik, dhënien e të drejtave të zhvillimit në Sheshin e Projektit, parimet e drejtimit të biznesit të Investitorit Strategjik dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve. Dorëzimi i sheshit të ndërtimit do të ndahet në dy faza:

- *Faza e parë* do të përfshijë dorëzimin e pjesës së Sheshit të Projektit të përshkruar më hollësisht sipas Master Planit të miratuar dhe Planit të Biznesit.
- *Faza e dytë* do të përfshijë dorëzimin dhe zhvillimin e Sheshit të Projektit, përshkruar më hollësisht sipas Master Planit dhe Planit të Biznesit të miratuar.

Pjesë plotësuese e projektit Marina & Jahtet e Durrësit është dhe marrëveshja për “Marinën Durrës”, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Investitorit Strategjik. Këshilli i Ministrave, shoqëria Eagle Hills Real Estate Development SHPK (Eagle Hills) dhe shoqëria Albanian Seaports Development Company SHPK (ASDC)), kanë lidhur marrëveshjen për zhvillimin e Sheshit të Projekteve në një zhvillim dhe Marinë të klasit botëror dhe me përdorime të shumëfishta.

Në objektin e Marrëveshjes është parashikuar që Investitori Strategjik ka të drejtën ekskluzive të marrë në përdorim dhe të përdorë Marinën (Porti Marina Jahte Durrës) me përdorim të shumëfishtë në territorin e përcaktuar sipas koordinatave të përfshira në aneksin e marrëveshjes dhe të zbatojë Master Planin e Marinës dhe Planin e Biznesit të Marinës në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm dhe këtë Marrëveshje.

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, objektit të aktivitetit të shoqërisë së përbashkët (JV) Durrës Marina SHA; objektit të Marrëveshjes Kuadër dhe Marrëveshjes së Marina Durrës, si dhe analizave të mëparshme të trajtuara nga Autoriteti i Konkurrencës për shërbimet në portet detare, treg përkatës i prekur nga transaksioni është përcaktuar (i) tregu i ndërtimit; shitjes dhe menaxhimit të pasurive të paluajtshme dhe (ii) tregu i ndërtimit dhe shërbimit të marinës së jahteve.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i **qytetit të Durrësit**.

Tregu i ndërtimit, shitjes dhe menaxhimit të pasurive të paluajtshme.

Me ligjin nr.79, datë 24.11.2022 “Për miratimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albanian Seaports Development Company SHA, dhe NSHMI Development L.L.C., në lidhje me projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit”, bashkëlidhur marrëveshjeve është depozituar Plani i Biznesit-Master Plan i Projektit.

Projekti Durrës Yachts & Marina do të shtrihet në pjesën lindore të portit të Durrësit, me një sipërfaqe neto prej 440 mijë m². Durrës Yachts & Marina është një projekt unik me potencialin për të transformuar qytetin e Durrësit dhe për të shërbyer si një histori suksesi për projekte të mëtejshme vizionare dhe investime të huaja në Shqipëri.

Masterplani përfshinë zona të ndryshme si Marina, Plazhi, Bregdeti, Parku, Qyteti i Vjetër dhe Komunitetet Bregdetare. Ky projekt i konceptuar si një kompleks turistik rezidencial do të sjellë një zhvillim të madh edhe në infrastrukturë, pasi ndërtimi i sistemit rrugor të këtij kompleksi do të sjellë zhvillim edhe për zonën përreth. Projekti do të zhvillohet në një sipërfaqe totale prej 1.3 mln m² GFA, në një sipërfaqe neto prej rreth 440 mijë m². Zhvillimi i këtyre zonave ofron më shumë mundësi punësimi, krijon kushte më të mira jetese dhe më shumë përfitime ekonomike për komunitetin.

Durrës Yacht & Marina do të ofrojë për qytetin e Durrësit zhvillimin e kësaj zone, e cila do të sjellë komunitetit përfitime sociale, që përfshijnë: Ruajtjen e kulturës dhe trashëgimisë lokale; Forcimi i komunitetit; Ofrimi i shërbimeve sociale; Komercializimi i kulturës dhe artit dhe Rigjallërimi i artit dhe kulturës.

Krijimi i ndërmarrjes së përbashkët, Durrës Marina SHA, për zhvillimin e Planit të Biznesit Marina & Jahtet e Durrësit, në tregun e ndërtimit; shitjes dhe menaxhimit të pasurive të paluajtshme pritet të sjellë zhvillim ekonomik, social dhe kulturor në tregun përkatës të produktit.

Tregu i ndërtimit dhe shërbimit të marinës së jahteve.

Referuar planit të biznesit, projekti ka parashikuar ndërtimin e Marinës e cila do të përfshijë deri në 280 vende parkimi për jahte.

Ndërtimi dhe përdorimi i marinës është e parashikuar në Marrëveshjen për “Marinën Durrës”, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Investitorit Strategjik. Këshilli i Ministrave, shoqëria Eagle Hills Real Estate Development SHPK (Eagle Hills) dhe shoqëria Albanian Seaports Development Company SHPK (ASDC).

Kjo marrëveshje, është bërë objekt shqyrtimi nga Komisioni i Konkurrencës, i cili në vendimin nr. 917 datë 24.10.2022 “Mbi disa rekomandime në lidhje me draft marrëveshjes kuadër për projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit” dhe marrëveshjeve të tjera të dakortësuara ndërmjet

Komitetit të Negociimit të Marrëveshjeve dhe Subjektit Investues, Eagle Hills Real Estate Development SHPK”, ka evidentuar që draft Marrëveshja mes MIE-s dhe Investitorit Strategjik për “Marinën Durrës” përmban klauzola ekskluziviteti, pikërisht për shërbimet e parashikuara në seksionin 2.04 të Marrëveshjes për “Marinën Durrës”, për parkim sezonal, parkim i zgjatur dimëror, parkim i zgjatur vjetor; rimbushje me karburant, shërbime mbështetëse të nevojshme dhe çdo shërbim tjetër të lidhur me aktivitetin e biznesit të Investitorit Strategjik (JV).

Draft Marrëveshja Kuadër dhe draft Marrëveshja për “Marinën Durrës” (mes MIE-s dhe JV) i jep Investitorit Strategjik, shoqërisë Durrës Marina SHA të drejtën ekskluzive për përdorimin e Portit Marina Jahte Durrës dhe zotërimin e lirë të zonës.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës është shprehur në vendimin nr. 917 datë 24.10.2022 “Mbi disa rekomandime në lidhje me draft marrëveshjes kuadër për projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit” dhe marrëveshjeve të tjera të dakortësuara ndërmjet Komitetit të Negociimit të Marrëveshjeve dhe Subjektit Investues, Eagle Hills Real Estate Development SHPK”, në zbatim të së cilës po vlerësohet kjo marrëveshje.

Nga sa analizuar më lart, transaksioni i krijimit të ndërmarrjes së përbashkët, Durrës Marina SHA nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve. Për këto arsye, transaksioni i realizuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun e ndërtimit; shitjes dhe menaxhimit të pasurive të paluajtshme si dhe në tregun e ndërtimit dhe shërbimit të marinës së jahteve në qytetin e Durrësit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Eagle Hills Real Estate Development SHPK dhe Albanian Seaports Development Company SHA.
- II.** Detyrimin e shoqërisë Durrës Marina SHA, të respektojë zbatimin e nenit 9 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në tregun e shërbimit të marinës së jahteve.
- III.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 972, Datë 07. 04. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË NJËSISË SË BIZNESIT “MOBILITY SERVICE PLATFORM” NGA SHOQËRIA CARIAD SE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07. 04. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Njesisë së Biznesit “Mobility Service Platform” nga shoqëria CARIAD SE.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Njesisë së Biznesit “Mobility Service Platform” nga shoqëria CARIAD SE.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni në lidhje me përfitimin e kontrollit të Njesisë së Biznesit “Mobility Service Platform” nga shoqëria CARIAD SE.

Referuar dokumentit “Kontratë Blerje për Njësine e Biznesit “Mobility Service Platform”, të nënshkruar më datë 27 janar 2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: CARIAD SE është një shoqëri evropiane, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman, me objekt aktiviteti: zhvillimin dhe shitjen e zgjidhjeve softuerike për industrinë automobilistike dhe pjesëmarrjen në shoqëri të të gjitha llojeve, veçanërisht në industrinë e softuerit. CARIAD SE është një filial i zotëruar plotësisht nga shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft.

Volkswagen Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt veprimtarie: prodhimi dhe shitja e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, pjesëve të tyre si dhe të gjitha sistemeve, makinerive, veglave dhe produkteve të tjera teknike, shoqëria mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve të mëposhtme:

Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

Pala Shitëse: Hexad GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: zhvillimi dhe tregtimi i softuerëve dhe produkteve të tjera në sektorin e IT, ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes, trajnimeve, zhvillimi i projekteve dhe konsulencë.

Administratori i kësaj shoqërie është z. Suresh Shamanna.

Shoqëria Target: Njësia e Biznesit “Mobility Servis Platform zhvillon softuer të personalizuar në fushën e shërbimeve të lëvizshmërisë (p.sh. u mundëson përdoruesve të planifikojnë, rezervojnë dhe paguajnë për lloje të shumta të shërbimeve të lëvizshmërisë). Zhvillimi i softuerit bëhet sipas specifikimeve dhe kërkesave specifike të CARIAD SE. Softueri i zhvilluar më pas është në pronësi të CARIAD SE. Prandaj biznesi target nuk zotëron asnjë të drejtë IP pas zhvillimit të softuerit, por paguhet vetëm për ofrimin e shërbimit të zhvillimit.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Hexad GmbH (shitësi), shoqërisë CARIAD SE (blerësi) dhe personit fizik Suresh Shamanna (themeluesi) është lidhur Kontratë Blerje për Njësinë e Biznesit “Mobility Service Platform”, më datë 27 janar 2023.

Bazuar në termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë marrëveshje, shitësi synon të shesë Njësinë e Biznesit “Mobility Service Platform” (MSP) (në veçanti duke përfshirë të gjithë punonjësit, marrëdhëniet kontraktuale, rezultatet e punës dhe të drejtat e përdorimit, njohuritë dhe asetet e tjera thelbësore, që do t'i caktohen njësisë së biznesit në përputhje me këtë kontratë, por pa asetet dhe kontratat e përjashtuara nga kontrata) si njësi e veçantë biznesi e pavarur, organizative, një njësi biznesi e aftë për funksionim.

Bazuar në Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3 “Objekti i Kontrollit”, parashikohet se: “Objekt i kontrollit mund të jenë një ose më shumë, ose gjithashtu pjesë të ndërmarrjeve të cilat përbëjnë njësinë ligjore, ose aseteve të kësaj njësie ose vetëm një pjesë e këtyre aseteve. Përfitim i kontrollit mbi asetet mund të konsiderohet si një përqendrim, vetëm nëse këto asete përbëjnë ndërmarrjen si një e tërë ose një pjesë të saj d.m.th. një biznes me një përfaqësim në treg, e cila ka një xhiro vjetore tregu. Një transaksion në lidhje me asetet e pa-prekshme të tilla si markat, patentat ose të drejtën e autorit mund të konsiderohet si një përqendrim nëse këto asete përbëjnë një biznes me një xhiro vjetore. Në çdo rast, transfertat e licencave të markës, patentave dhe të drejtave të autorit, pa

asete të tjera shtesë, mundet vetëm të plotësojë këto kritere, nëse licencat janë ekskluzive në të paktën një territor të caktuar dhe transfertat e këtyre licencave do të transferojnë aktivitetin që gjeneron xhiroja”.

Nga vlerësimi i marrëveshjes konstatohet se Mobility Service Platform përbën një njësi biznesi me përfaqësim në treg, e cila krijon xhiro dhe në përfundim të transaksionit, kjo njësi do të zotërohet plotësisht nga CARIAD SE.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ofrimit të shërbimeve IT për programim/zhvillim softueri të bërë me porosi (softuer individual), por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të Njesisë së Biznesit “Mobility Service Platform” nga shoqëria CARIAD SE. Njësia e Biznesit MSP zhvillon softuer të personalizuar në fushën e shërbimeve të lëvizshmërisë, operon si një njësi ekonomike dhe realizon një xhiro vjetore.

Shoqëria CARIAD SE është një filial në pronësi të plotë të Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG), ndërmarrja mëmë e Grupit Volkswagen, grup i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK, në tregun e shitjes së automjeteve dhe në tregun e qerasë financiare e sigurime.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të Njesisë së Biznesit “Mobility Service Platform” nga shoqëria CARIAD SE.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 973, Datë 07. 04. 2023

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË KUTOAVE TË SHOQËRISË KHIDRAT RENEWABLE ENERGY PRIVATE LIMITED NGA SHOQËRIA SOURYA MANTHAN RENEWABLE ENERGY PRIVATE LIMITED”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07. 04. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited.

Bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, me vendimin nr. 965, datë 17.03.2023, “Mbi autorizimin e përqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited”, vendosi:

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitohet pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Me shkresën nr. 160/5, datë 28.03.2023 “Njoftim përqendrimi në kuadër të njoftimit të përfuturit të kontrollit të Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited mbi Khidrat Renewable Energy Private Limited”, jemi njoftuar se shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited ka nënshkruar “Marrëveshje për transferimin e kuotave”, datë 14 mars 2023, mbi blerjen e kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited.

Referuar “Marrëveshje për transferimin e kuotave”, palët janë:

Pala blerëse: Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Indisë, e cila operon në biznesin e ndërtimit dhe furnizimit me energji të rinovueshme për klientët.

Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited është një filial i Statkraft IH Holdings AS, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë dhe objekt aktiviteti: veprimtari në fushën e ndërtimit, operimit dhe furnizimit të klientëve me energji të rinovueshme. Statkraft IH Holdings AS është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS (shoqëria mëmë e fundit), në pronësi të shtetit norvegjez.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike, etj.

Devoll Hydropower SHA, shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësisve prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pala shitëse: Enel Green Power India Private Limited është një shoqëri, e themeluar sipas legjislacionit të Indisë.

Shoqëria Target: Khidrat Renewable Energy Private Limited, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Indisë e angazhuar në ndërtimin, operimin dhe furnizimin me energji nga dielli për klientët.

Khidrat Renewable Energy Private Limited zotërohet nga shoqëria Enel Green Power India Private Limited dhe Z. Sandy Khera.

Target nuk ka prezencë dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Enel Green Power India Private Limited (shitësi), shoqërisë Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited (blerësi) dhe shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited është lidhur “Marrëveshje për transferimin e kuotave”, e nënshkruar datë 14 mars 2023.

Bazuar në “Marrëveshje për transferim kuotash”, shitësi dhe ortaku i nominuar i shitësit (Z. Sandy Khera) zotërojnë dhe mbajnë kolektivisht të gjitha kuotat e shitjes, të lira dhe të qarta nga çdo barrë dhe kanë rënë dakord t’jua shesin blerësit dhe blerësi, duke u mbështetur në garancinë e shitësit, marrëveshjet dhe detyrimet e tjera të ndërmarra nga shitësi dhe ortaku i nominuar i shitësit, ka rënë dakord të blejë kuotat e shitjes.

Detyrimi i blerësit për të blerë kuotat e shitjes do të jetë subjekt dhe i kushtëzuar me përmbushjen e secilit prej kushteve paraprake dhe kushteve pasuese sipas kërkesës së blerësit. Mbyllja e këtij transaksioni do të bëhet pas plotësimit të veprimeve të përcaktuara në marrëveshje.

Pas përfundimit të shitjes dhe blerjes së kuotave në datën e mbylljes, blerësi do të zotërojë 100% shoqërinë Khidrat Renewable Energy Private Limited.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvencionale, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited.

Shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited zotërohet 100% nga Statkraft IH Holding AS, pjesë e Grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të tij, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Targeti Khidrat Renewable Energy Private Limited është i angazhuar në ndërtimin, operimin dhe furnizimin me energji nga dielli për klientët. Shoqëria nuk është prezente dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri. Aktiviteti i saj fokusohet në ndërtimin e projektit të energjisë diellore në rrethin Bikaner dhe Rajasthan (një shtet në Indinë Perëndimore).

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së kuotave të shoqërisë Khidrat Renewable Energy Private Limited nga shoqëria Sourya Manthan Renewable Energy Private Limited.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 974, Datë 14. 04. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË NIRA DYNAMICS AB NGA SHOQËRIA CARIAD SE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 04. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë NIRA Dynamics AB nga shoqëria CARIAD SE.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit kontrollit të vetëm të shoqërisë NIRA Dynamics AB nga shoqëria CARIAD SE.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni në lidhje me përfutimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë NIRA Dynamics AB nga shoqëria CARIAD SE.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shit-blerje aksionesh”, të nënshkruar më datë 12 janar 2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: CARIAD SE është një shoqëri evropiane, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman, me objekt aktiviteti: zhvillimin dhe shitjen e zgjidhjeve softuerike për industrinë automobilistike dhe pjesëmarrjen në shoqëri të të gjitha llojeve, veçanërisht në industrinë e softuerit. CARIAD SE është një filial i zotëruar plotësisht nga shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft.

Volkswagen Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt veprimtarie: prodhimi dhe shitja e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, pjesëve të tyre si dhe të gjitha sistemeve, makinerive, veglave dhe produkteve të tjera teknike, shoqëria

mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve të mëposhtme:

Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

Pala Shitëse

- **Sigmoid AB**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit Suedez.
- **Z.Fredrik Gustafsson**, person fizik, banues në shtetin suedez dhe përfitues fundor i shoqërisë Sigmoid AB.

Fredrik Gustafsson zotëron rreth 3.97% të aksioneve të shoqërisë target dhe shoqëria Sigmoid AB zotëron rreth 1.37% të aksioneve. Aksionet e tjera të shoqërisë target zotërohen nga blerësi.

Shoqëria Target: NIRA Dynamics AB, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit suedez, me objekt aktiviteti: zhvillimin dhe tregtimin e komponentëve të avancuar softuerësh dhe sisteme të kompletuara, të integruara në fushën e dinamikës së automjeteve, si dhe të angazhohet në aktivitete që përputhen me to.

Shoqëria Target nuk është aktive dhe nuk gjeneron të ardhura në tregun shqiptar.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë CARIAD SE (blerësi), shoqërisë Sigmoid AB (shitësi 1) dhe z. Fredrik Gustafsson (shitësi 2), është lidhur “Marrëveshje shit-blerje aksionesh”, datë 12 janar 2023.

Referuar termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshjeje, shitësit pranojnë të shesin dhe blerësi pranon të blejë aksionet, së bashku me të gjitha të drejtat e bashkangjitura me to.

Shitësit zotërojnë së bashku 5.34% të aksioneve të shoqërisë target.

Referuar Marrëveshjes së Ortakëve, datë 29 shtator 2004, të shoqërisë NIRA Dynamics AB, Pika 5 “Vendimet”, citohet se: Vendimet si; - ndryshimet dhe amendimet lidhur me Planin e Biznesit, - ndryshimet dhe amendimet e Statutit, - shitja biznesit të shoqërisë, - shitja dhe vendime të tjera mbi asetet e shoqërisë, - shpërndarja e fitimeve.... dhe -prishja vullnetare e shoqërisë, *duhet të miratohen nga të gjithë ortakët ose Anëtarët e Bordit me vendim unanimit*, duke u dhënë aksionareve të pakicës kontrollin e përbashkët të shoqërisë nëpërmjet të drejtës së vetos.

Pas implementimit të transaksionit të propozuar, blerësi do të blejë 5.34% të aksioneve të shoqërisë NIRA Dynamics AB, duke zotëruar 100% të kapitalit dhe duke ushtruar kontroll të vetëm në shoqërinë Target.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përmbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt

autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i kërkimit dhe zhvillimit të zgjidhjeve softuerike të shpëtimit, veçanërisht në sistemet e monitorimit dhe paralajmërimit për industrinë e automjeteve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë NIRA Dynamics AB nga shoqëria CARIAD SE.

Target nuk është aktiv dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Blerësi, shoqëria CARIAD SE është një filial në pronësi të plotë të Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG), ndërmarrja mëmë e Grupit Volkswagen, grup i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK aktive në tregun e shitjes së automjeteve dhe në tregun e qerasë financiare e sigurime.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë NIRA Dynamics AB nga shoqëria CARIAD SE.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 975, Datë 14.04.2023

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJEVE AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, DEVI 20 - GRUP SHPK, EQEREM-934 SHPK, FERRA & CO SHPK, GLOBCOM SHPK, KRIKET-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK DHE PDF SHPK NË TREGUN E IMPORTIT, PRODHIMIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË VAJIT VEGJETAL”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.04.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, DEVI 20 - GRUP SHPK, EQEREM-934 SHPK, FERRA & CO SHPK, GLOBCOM SHPK, KRIKET-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK dhe PDF SHPK në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43 pika 5 e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal, dhe;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi Raportin e hetimit të thelluar;

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur:

1. Nisur nga shqetësimet e ngritura në media mbi rritjen e çmimit të vajit vegjetal, AK bazuar në nenin 28, germa (a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës, ka monitoruar tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, me qëllim vlerësimin e konkurrencës në këtë treg.

2. Nga vlerësimi i informacionit të grumbulluar gjatë monitorimit të kryer pranë subjekteve që tregtojnë këtë produkt, u konstatua se çmimi i vajit të lulediellit ka pësuar rritje duke filluar që nga muaji dhjetor 2020, me një rritje prej 10 lekë deri në muajin mars, dhe në muajt në vazhdim kjo rritje ka vijuar me nga 5 lekë. Për pasojë sjellja e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim nenit 4, pika 1 dhe nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
3. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës me vendim nr. 803, datë 28.05.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal” dhe me vendimin nr. 815, datë 02.09.2021 “Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 803, datë 28.05.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg.
4. Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës, në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me vendimin nr. 870, datë 18.03.2022 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, DEVI 20 - GRUP SHPK, EQEREM-934 SHPK, FERRA & CO SHPK, GLOBCOM SHPK, KRIKET-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK dhe PDF SHPK në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal”, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në këtë treg për periudhën kohore nga 20 maj 2021 deri në 18 mars 2022.
5. Në vazhdim të procedurës, në zbatim të Vendimit nr. 870, datë 18.03.2022, të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 245/7, datë 23.06.2021 “Autorizim inspektorësh”, Inspektorët e Autoritetit, gjatë periudhës së hetimit të thelluar proceduan me kryerjen e inspektimit pranë ndërmarrjeve nën hetim.
6. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, DEVI 20 - GRUP SHPK, EQEREM-934 SHPK, FERRA & CO SHPK, GLOBCOM SHPK, KRIKET-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK dhe PDF SHPK.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.

8. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 870, datë 18.03.2022 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, DEVI 20 - GRUP SHPK, EQEREM-934 SHPK, FERRA & CO SHPK, GLOBCOM SHPK, KRIKET-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK dhe PDF SHPK në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal, tregu përkatës i produktit përfshin, tregu përkatës i produktit përfshin: (i) Tregun e importit të vajit vegjetal; (ii) Tregun e ambalazhimit të vajit vegjetal; (iii) Tregun e shitjes me shumicë të vajit vegjetal.
9. Në Republikën e Shqipërisë tregtohet vaji i importuar i hapur (i gatshëm për t’u ambalazhuar në vend ose për t’u shitur si i hapur) dhe ai i importuar i ambalazhuar i gatshëm për t’u shitur. Pra, tregu përkatës i produktit përfshin tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të vajit vegjetal të hapur dhe të ambalazhuar.
10. Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës, për nga përdorimi, vaji i lulediellit ka përdorim më të gjerë në familje si për gatim, skuqje dhe sallatë. Vaji industrial dhe vaji i ëmbëlsirave janë përjashtuar nga tregu përkatës, sepse i pari përdoret për pajisje pune, ndërsa i dyti përdoret në punishtet e ëmbëlsirave, pra të dy këto lloje vajrash nuk kanë përdorim familjar. Vaji i sojës përdoret për gatim dhe ka vlera të larta ushqyese dhe kuruese (omega 3), por përdoret nga një kategori e caktuar, kryesisht nga personat mbi moshën 50 vjeç dhe ka një çmim shumë më të lartë se vaji i lulediellit. Vaji i misrit ka vlera të larta ushqyese, përdoret për gatim dhe skuqje, por për shkak të çmimit më të lartë, nuk përfshihet në tregun përkatës (megjithëse është një nga llojet e vajit vegjetal). Vaji i ullirit, gjithashtu, ka vlera të larta ushqyese, përdoret për gatim por nuk rekomandohet në skuqje, ka çmim më të lartë si edhe rregullohet me një ligj të veçantë dhe për këtë arsye nuk do të përfshihet në tregun përkatës. Nga ana e ofertës produktet janë të zëvendësueshme, sepse ndërmarrjet importuese janë të lira të zgjedhin llojin e vajit që duan të importojnë. Pra, tregu përkatës i produktit përfshin vajin e lulediellit.
11. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet ofrimit të tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

III.2 Struktura e tregut sipas sasisë së importuar

12. Përcaktimi i strukturës së tregut është realizuar mbi treguesin e vlerës së importit të vajit të lulediellit të importuar për periudhën 20 maj 2021 - 18 mars 2022. Treguesit për vitin 2022 janë për 3 mujorin e parë të vitit 2022 dhe nuk mund të tregojnë strukturën përfundimtare të vitit përkatës. Për këtë arsye pjesët e tregut të ndërmarrjeve i përkasin vitit me tregues të plotë, 2021.
13. Ndërmarrjet me pjesën më të madhe në tregun e importit të vajit të lulediellit për vitin 2021 janë përkatësisht ndërmarrjet: GLOBCOM SHPK me XXX% të tregut, DEVI 20 - GRUP SHPK me XXX% të tregut, kurse ndërmarrjet e tjera si KRIKET-1 SHPK ka XXX% të tregut, EQEREM-934 SHPK ka XXX% të tregut etj. Ndërsa 49 ndërmarrje të tjera kanë më pak se XXX% të tregut dhe përbëjnë në total XXX% pjesë tregu.

14. Për periudhën 1 janar - 18 mars 2022, ndërmarrjet të cilat zënë pjesën më të madhe janë përsëri GLOBCOM SHPK me XXX% të tregut dhe DEVI 20 - GRUP SHPK me XXX% të tregut. Në këtë periudhë ndërmarrjet EQEREM-934 SHPK dhe FERRA & CO SHPK kanë zënë më shumë pjesë tregu se në 2021 përkatësisht me XXX% dhe XXX%.
15. Tabela e treguesve të përqendrimit për tregun e importit tregon për një treg mesatarisht të përqendruar duke parë që treguesi HHI për vitin 2021 ka vlerën 1584.32, ndërsa për periudhën 1 janar – 18 mars 2022 vlera e HHI është në vlerën 1842.73.
16. Treguesit në lidhje me shkallën e përqendrimit të tregut të importit (CR3; CR5) të importuesve më të mëdhenj për vitin 2021, CR3 dhe CR5 kanë përkatësisht vlerat XXX% dhe XXX% dhe për periudhën 3 mujore të vitit 2022 CR3 dhe CR5 kanë përkatësisht vlerat XXX% dhe XXX%. Nga këto karakteristika konstatojmë se për vitin 2021 tregu i importit të vajit të lulediellit është një treg mesatarisht i përqendruar.
17. Vendi më i madh eksportues i vajit të lulediellit gjatë periudhës 20 maj - 31 dhjetor 2021 është Federata Ruse, nga ku është importuar një sasi prej XXX dhe pas saj në renditje vjen Ukraina dhe Hungaria nga ku janë importuar përkatësisht XXX litra dhe XXX litra. Për periudhën gati 3 mujore të vitit 2022, renditja është pothuajse e njëjtë po sasi të importuara janë ndjeshëm më të vogla.
18. Në tregun e importit dhe të shitjes me shumicë të vajit të lulediellit ushtrojnë veprimtarinë rreth 80 ndërmarrje, ndërsa në tregun e ambalazhimit, bazuar në përgjigjen e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, operojnë 18 ndërmarrje. Ndërmarrjet dalin në treg me një shumëllojshmëri markash si: PDF SHPK me markën Olim, DEVI 20 - GRUP SHPK me markën Floriol, BOMIRA SHPK me 2 marka, FERRA & CO SHPK me markën Ferra King dhe Solei, etj. Ekzistenca e shumë markave në treg bën që të ketë shumëllojshmëri zgjedhjeje për konsumatorët.
19. Tre ndërmarrjet që kanë realizuar më shumë shitje janë GLOBCOM SHPK (që shet vetëm vaj të hapur, rifuxhio), FERRA & CO SHPK dhe PDF SHPK (blerësi kryesor i ndërmarrjes GLOBCOM SHPK). Nga analiza e çmimit mesatar të shitjes, është vënë re se ndërmarrjet që shesin vaj luledielli të ambalazhuar, konkurrojnë me çmimin e shitjes.
20. Nga analiza e performancës financiare mund të thuhet se, ndërmarrjet nën hetim operojnë me norma fitimi relativisht të ulëta. Për ndërmarrjet individualisht shohim se norma e fitimit është pozitive. Për vitin 2021 tre ndërmarrje kanë patur norma fitimi pak më të larta se të tjerat, AGROBLEND SHPK me XXX%, TEUTA SHPK me XXX% dhe DEVI 20 - GRUP SHPK me XXX%.

IV. Analiza e çmimit të shitjes me shumicë të vajit të lulediellit

21. Duke qenë se gjatë inspektimeve nuk u gjetën evidenca direkte mes konkurrenteve, grupi i punës ka kryer analizat ekonomike me qëllim evidentimin e ndonjë sjelljeje të bashkërenduar mes konkurrenteve për fiksimin direkt apo indirekt të çmimit të shitjes së produktit.
22. Bazuar edhe në materialin e OECD¹ për zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara pa evidence direkte, analizat ekonomike të sjelljes të cilat realizohen në rastet kur nuk ka evidence direkt janë si më poshtë: analiza e çmimeve paralele për të parë ndryshimet identike në çmimet e ndërmarrjeve konkurrense nëse janë kryer në të njëjtën kohë, fitime shumë të larta të pajustificueshme, qëndrueshmëria e pjesëve të tregut, historiku i shkeljeve të ligjit të konkurrencës. Për sa i përket evidencave që lidhen me strukturën e tregut të cilat mund të lehtësojnë marrëveshjet kartel mund të jenë: përqendrim i lartë i tregut, barriera të larta në hyrje, nivel i lartë i integritit vertikal dhe produkte homogjene.
23. Analiza e sjelljes se ndërmarrjeve në lidhje me çmimin e shitjes me shumicë ka për qëllim të vlerësojë nëse ndërmarrjet vendosin direkt apo indirekt çmimet e shitjes me shumicë gjatë periudhës në hetim.
24. Paketimi më i shitur i produktit vaj luledielli është ai i vajit 1 Litër, i cili ka një diferencë të madhe me sasinë e shitur të paketimeve të tjera. Për këtë arsye, në vlerësimin e trendit të ndryshimit të çmimit mesatar të shitjes është marrë në konsideratë krahasimi i çmimit mesatar mujor të shitjes së vajit të lulediellit në formatin 1 litër.
25. Çmimet mesatare mujore të shitjes me shumicë nuk janë të përafërta për ndërmarrjet. Në muajin dhjetor 2021 çmimet mesatare të shitjes me shumicë të ndërmarrjes BOMIRA SHPK (për njërin nga markat e saj të vajit, në formatin 1 litër) dhe FERRA & CO SHPK (vaji King, në formatin 1 litër) janë shumë të ngjashme, me diferencë më të vogël se XXX lekë. Këto çmime mesatare, nga muaji tetor 2021, kur ndërmarrja BOMIRA SHPK e ka futur për herë të parë në treg janë rritur përkatësisht me XXX% për ndërmarrjen BOMIRA SHPK dhe XXX% për ndërmarrjen FERRA & CO SHPK. Më pas, çmimet janë ulur lehtësisht për ndërmarrjen BOMIRA deri në XXX% deri në shkurt 2022 duke patur çmimin më të lartë në mars 2022 me XXX lekë/litër. Për ndërmarrjen FERRA & CO SHPK, çmimi i vajit King 1 litër, ulet në muajin janar 2022 në vlerën XXX lekë/litër dhe më pas rritet duke patur çmimin maksimal në muajin mars 2022 me XXX lekë/litër. Gjatë periudhës në hetim nuk ka patur çmime mesatare mujore të njëjta të shitjes me shumicë të vajit të lulediellit për ndërmarrjet BOMIRA SHPK dhe FERRA & CO SHPK.
26. Duke qenë se në muajin dhjetor 2021 çmimi mesatar mujor i shitjes me shumicë i ndërmarrjes BOMIRA SHPK dhe FERRA & CO SHPK është shumë të përafërt, u analizua çmimi i shitjes mesatar ditor për këtë muaj për këto dy ndërmarrje.
27. Vihet re se, në asnjë datë nuk ka një çmim mesatar ditor të njëjtë midis ndërmarrjeve BOMIRA SHPK dhe FERRA & CO SHPK, pavarësisht se çmimi mesatar mujor i shitjes me shumicë

¹ Prosecuting Cartels Without Direct Evidence 2006

<https://www.oecd.org/daf/competition/prosecutionandlawenforcement/37391162.pdf>

është shumë i përafërt për këtë muaj. Kjo ndodh edhe për shkak se gjatë të njëjtës datë ndërmarrjet aplikojnë çmime të shitjes me shumicë të ndryshme për sasi të ndryshme.

28. Nga krahasimi i çmimeve mesatare mujore të shitjes të ndërmarrjeve në hetim në periudhën 20 maj 2021 – 18 mars 2022, për produktin vaj luledielli rezulton se:

- Gjatë kësaj periudhe vihet re se ndërmarrjet nuk aplikojnë çmime të njëjta por trendi i çmimeve gjatë periudhës janar – shkurt 2022 është rritës, si pasojë e konfliktit në Ukrainë, vend që zotëron edhe afërsisht 45 – 50% të prodhimit botëror të vajit të lulediellit, i cili është edhe një nga burimet kryesore të furnizimit për subjektet që operojnë në treg.
- Rritja e çmimit të shitjes me shumicë për të gjitha ndërmarrjet ka qenë në periudhën janar – shkurt 2022, periudhë e cila përkon edhe me rritjen e çmimit mesatar të importit nga të dhënat e DPD.
- Vihet re se çmimet mesatare mujore të shitjes me shumicë nuk janë të përafërta për ndërmarrjet.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43 pika 5 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, BOMIRA SHPK, DEVI 20 - GRUP SHPK, EQEREM-934 SHPK, FERRA & CO SHPK, GLOBCOM SHPK, KRIKET-1 SHPK, TEUTA DURRES SHPK dhe PDF SHPK në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 976, Datë 14.04.2023

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.04.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit”.

Bazë ligjore: Neni 4 dhe 9, neni 24, shkronja d), neni 26, neni 43, pika 5, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit; dhe;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit paraprak,
-

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka zhvilluar procedurën e monitorimit të tregut të prodhimit të betonit, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në këtë treg.
2. Komisioni i Konkurrencës, në përfundim të këtij monitorimi, me vendimin nr. 913, datë 06.10.2022, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit, për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9121/2003. Hetimi paraprak përfshin periudhën kohore 1 Janar 2020 deri në 30 Shtator 2022.

3. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 406/11, datë 06.10.2022 "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, gjatë periudhës së hetimit paraprak kryen inspektime pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit.
4. Në vazhdim të procedurës, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", gjatë periudhës së hetimit paraprak janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të betonit; Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës; Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë; Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; si dhe Qendra Kombëtare e Biznesit.

II. ANALIZA E KONKURRENCËS

II.1 Tregu përkatës

5. Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
6. Bazuar në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121/2003 dhe Udhëzimin nr. 76, datë 07.06.2008, "Për përcaktimin e Tregut Përkatës", Tregu përkatës i produktit përcaktohet si: *"Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre"*.
7. Betoni i gatshëm është një përzierje e çimentos, zhavorrit, rërës dhe ujit. Fortësia e betonit varet nga përmbajtja e çimentos (në sasi dhe cilësi) në krahasim me përbërësit e tjerë, pra sa më e lartë përmbajtja e çimentos, aq më i fortë është betoni. *Betoni ndahet në marka të ndryshme në varësi të forcës dhe kohës që i duhet përzierjes për t'u forcuar.*
8. Referuar faktorëve të vlerësimit të tregut përkatës si zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës dhe ofertës, homogjenitetit të produktit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të produkteve, për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, vlerësojmë se tregu përkatës i produktit në këtë rast është: *tregu i prodhimit dhe tregtimit të betonit të gatshëm, i ndarë në nën tregje sipas markave të betonit (M 150, M 200, M 250, M 300, M 350, M 370, M 400, M 450) në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit.*
9. Referuar karakteristikave të produktit beton, i cili mund të transportohet në një distancë të kufizuar nga vendi i prodhimit do të analizohet sjellja e ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtari brenda një zone gjeografike rajonale. Në këtë zonë janë përcaktuar ndërmarrjet të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit. *Pra tregu përkatës gjeografik do të jetë rajonal dhe në rastin tonë përfshin qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit.*

II.3 Struktura e tregut dhe sjellja e ndërmarrjeve në treg

10. Tregu i prodhimit dhe shitjes me shumicës të betonit është i përbërë nga shumë ndërmarrje të cilat

operojnë në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit për vitet 2020, 2021 dhe periudhën janar - shtator 2022.

11. Nga të dhënat e përpunuara gjatë procedurës hetimore mbi sasisë e prodhuara dhe shitura sipas ndërmarrjeve për produktin beton rezulton se:
 - Për vitin 2020, ndërmarrjet që operojnë në qarkun e Tiranës kane prodhuar X% të sasisë totale të produktit beton për të treja qarqet së bashku, ndërmarrjet në qarkun e Durrësit kanë prodhuar X % dhe ndërmarrjet në qarkun e Elbasanit kanë prodhuar X%.
 - Për vitin 2021, ndërmarrjet që operojnë në qarkun e Tiranës kane realizuar X% sasisë totale të produktit beton për të treja qarqet së bashku, ndërmarrjet në qarkun e Durrësit kanë prodhuar X % dhe ndërmarrjet në qarkun e Elbasanit kanë realizuar X%.
 - Për periudhën janar - shtator 2022, ndërmarrjet që operojnë në qarkun e Tiranës kane prodhuar X% të sasisë totale të produktit beton për të tre qarqet së bashku, ndërmarrjet në qarkun e Durrësit kanë prodhuar X % dhe ndërmarrjet në qarkun e Elbasanit kanë prodhuar X%.
12. Për vitin 2020 në qarkun e Tiranës ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes së betonit X ndërmarrje. Referuar sasisë totale të prodhuar dhe shitur ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut për vitin 2020 është ndërmarrja Alba Beton SHPK e cila zotëron rreth X % të tregut sipas sasisë totale të prodhuar dhe shitur, e ndjekur nga ndërmarrja Fortis Beton Co SHPK e cila zotëron rreth X % të tregut. Ndërmarrjet Ferro Beton & Construction Co SHA dhe Alesio 2014 SHPK zotërojnë secila përkatësisht rreth X% dhe X% të tregut për vitin 2020. Ndërmarrja Eurobeton - X SHPK zotëron rreth X% të tregut dhe ndërmarrja Sina 98 SHPK zotëron rreth X % të tregut. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve zotërojnë pjesë të vogla të tregut nën X %. Për vitin 2020 asnjë nga ndërmarrjet që ushtron veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes së betonit në qarkun e Tiranës nuk zotëron pjesë tregu më të madhe se 40%.
13. Për vitin 2021, vihet re se ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes së betonit X ndërmarrje, kjo pasi kemi hyrjen në treg të ndërmarrjes Anchor Beton SHPK. Për vitin 2021, referuar sasisë totale të prodhuar dhe shitur, ndërmarrja me pjesën më të madhe në tregun e prodhimit të betonit në qarkun e Tiranës është përsëri ndërmarrja Alba Beton SHPK me rreth X % të tregut, e ndjekur nga ndërmarrjet Alesio 2014 SHPK, Fortis Beton Co SHPK dhe Ferro Beton & Construction Co SHA me përkatësisht X %, X % dhe X % të tregut për vitin 2021. Ndërmarrja Sina 98 SHPK zotëron pjesën prej rreth X % të tregut e ndjekur nga ndërmarrja Beton Express 2018 SHPK me X % të tregut. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve zotërojnë pjesë të vogla të tregut nën X %. Edhe për vitin 2021 asnjë nga ndërmarrjet që ushtron veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes së betonit në qarkun e Tiranës nuk zotëron pjesë tregu më të madhe se 40%.
14. Për periudhën janar-shtator të vitit 2022, ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut të prodhimit të betonit sipas sasisë së prodhuar dhe shitur është përsëri ndërmarrja Alba Beton SHPK e cila zotëron pjesën prej rreth X %, e ndjekur nga ndërmarrjet Alesio 2014 SHPK dhe Fortis Beton Co SHPK përkatësisht me rreth X % dhe X% të tregut. Ndërmarrja Anchor Beton SHPK e cila hyri në tregun e prodhimit dhe shitjes së betonit në gjysmën e dytë të vitit 2021, zotëron një pjesë tregu me rreth X %. Ndërmarrja Ferro Beton & Construction Co SHA zotëron rreth X % të tregut dhe ndërmarrja Sina 98 SHPK zotëron rreth X % të tregut. Ndërmarrjet e tjera, referuar 9- mujorit të parë të vitit 2022 zotërojnë pjesë të vogla të tregut nën X %.

15. Nga vlerësimi i pjesëve të tregut të ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes së betonit të gatshëm në qarkun e Tiranës vërehet se:
- Janë rreth X ndërmarrje të cilat ushtrojnë veprimtari në këtë qark;
 - Pjesët e tregut të ndërmarrjeve janë të ndryshueshme nga vitit në vit, pra nuk vërehet qëndrueshmëri në pjesët e tregut sipas sasisë;
 - Gjatë periudhës hetimore vërehet vetëm një hyrje e re në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit, duke zotëruar pjesë të konsiderueshme tregu për një periudhë të shkurtër.
 - Referuar treguesve të përqendrimit, tregu i prodhimit dhe shitjes së betonit është një treg mesatarisht i përqendruar me një numër të konsiderueshëm ndërmarrjesh që zotërojnë pjesë jo të mëdha tregu.
16. Nga analiza e çmimeve mesatare mujore të shitjeve me shumicë të produktit beton në qarkun e Tiranës, vërehet se çmimet e aplikuara nga ndërmarrjet janë të ndryshme nga njëra - tjetra dhe ritmi i ndryshimit të tyre është i ndryshëm, duke mos vërejtur shenja të caktimit të çmimeve apo koordinimit të tyre në ritmin e rritjes apo të zbritjes në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
17. Për vitin 2020 në qarkun e Durrësit ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes së betonit X ndërmarrje. Ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut për vitin 2020 është ndërmarrja 3D shpk e cila zotëron X% të tregut sipas sasisë totale të prodhuar dhe shitur. Ndërmarrja Rrotull Beton zotëron X% të tregut, ndërmarrjet Dulla Konstruksion dhe CO-Beton zotërojnë përkatësisht nga X% dhe X% të tregut për vitin 2020. Ndërmarrja Delta Construction ka zënë pjesën prej X% të tregut dhe ndërmarrja Sinameta me X% të tregut.
18. Për vitin 2021 vërehet hyrja e tre ndërmarrjeve të reja që kanë marrë pjesë tregu të konsiderueshme. Për vitin 2021, janë ndërmarrjet 3 D dhe Dulla Konstruksion të cilat zotërojnë secila nga X% të tregut. Ndërmarrja e tretë me pjesë më të lartë tregu për vitin 2021 është ndërmarrja e re E&E ndërtim e cila ka zënë rreth X% të tregut. Edhe ndërmarrja Dragon e cila ka filluar aktivitetin në vitin 2021 ka zënë rreth X% të tregut. Gjithashtu edhe ndërmarrja Rrotull Beton për vitin 2021 zotëron pjesën prej X % e ndjekur nga ndërmarrja CO-Beton me X% të tregut.
19. Për periudhën janar-shtator të vitit 2022, ndërmarrja me pjesë më të madhe të tregut të prodhimit të betonit sipas sasisë së prodhuar dhe shitur është ndërmarrja E&E e cila zotëron pjesën prej X%, e ndjekur nga ndërmarrja 3D me X%, ndërmarrja Delta Construction me X%, Dragon me X% dhe CO-Beton me X%. Ndërmarrjet e tjera, referuar 9- muorit të parë të vitit 2022 kanë zënë pjesë të vogla të tregut nën X%.
20. Nga vlerësimi i pjesëve të tregut të ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes së betonit të gatshëm në qarkun e Durrësit vërehet se:
- Janë rreth X ndërmarrje të cilat ushtrojnë veprimtari në këtë qark, ndër të cilat X prej tyre janë ndërmarrje të reja, të cilat kanë filluar ushtrimin e veprimtarisë në vitin 2021;
 - Pjesët e tregut të ndërmarrjeve janë të ndryshueshme nga vitit në vit, pra nuk vërehet qëndrueshmëri në pjesët e tregut sipas sasisë dhe ka hyrje të reja në treg, duke zotëruar pjesë të konsiderueshme tregu për një periudhë të shkurtër.
 - Gjatë periudhës hetimore asnjë nga ndërmarrjet që ushtron veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes së betonit në qarkun e Durrësit nuk zotëron pjesë tregu më të madhe se 40%, si një nga treguesit kryesorë për të evidentuar një ndërmarrje me pozitë dominuese.

21. Referuar indeksit të përqendrimit HHI rezulton se tregu i prodhimit dhe shitjes së produktit beton i gatshëm në qarkun e Durrësit është një treg mesatarisht i përqendruar, ku HHI për vitin X është në ulje si pasojë e rritjes së numrit të ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtari në këtë treg.
22. Nga analizimi i çmimeve mesatare mujore të aplikuara nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në qarkun e Durrësit vërehet se: çmimet mesatare mujore të e aplikuara nga ndërmarrjet për produktin beton, për të gjitha markat janë të ndryshme nga njëra-tjetra dhe ritmi i ndryshimit të tyre është i ndryshëm, duke mos vërejtur shenja të caktimit të çmimeve apo koordinimit të tyre në ritmin e rritjes apo të zbritjes në kuptim të nenit 4 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
23. Për vitin 2020 në qarkun e Elbasanit ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes së betonit X ndërmarrje. Ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut për vitin 2020 është ndërmarrja ELBA BETON shpk e cila zotëron X% të tregut sipas sasisë totale të prodhuar dhe shitur. Ndërmarrja DIEL shpk zotëron X% të tregut dhe ndërmarrja BENORDO shpk zotëron X% të tregut për vitin 2020.
24. Për vitin 2021, ndërmarrja me pjesë më të madhe në tregun e prodhimit të betonit në qarkun e Elbasanit është përsëri ndërmarrja ELBA BETON shpk me X% të tregut, e ndjekur nga ndërmarrja DIEL shpk me X% të tregut. Ndërmarrja e tretë zë rreth X% të tregut.
25. Për periudhën janar-shtator të vitit 2022, ndërmarrja me pjesë më të madhe të tregut të prodhimit të betonit sipas sasisë së prodhuar dhe shitur është përsëri ndërmarrja ELBA BETON shpk e cila zotëron pjesën prej X%, e ndjekur nga ndërmarrja DIEL shpk me X%. Ndërmarrja BENORDO shpk zotëron një pjesë tregu të papërfillshme prej X%.
26. Nga analizimi i pjesëve të tregut të ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe shitjes së betonit të gatshëm në qarkun e Elbasanit vërehet se:
 - Janë X ndërmarrje të cilat ushtrojnë veprimtari në këtë qark;
 - Pjesët e tregut të ndërmarrjeve kanë qëndrueshmëri në pjesët e tregut sipas sasisë;
 - Gjatë periudhës hetimore nuk vërehen hyrje të reja të ndërmarrjeve në treg.
27. Referuar indeksit të përqendrimit HHI rezulton se tregu i prodhimit dhe shitjes së produktit beton i gatshëm në qarkun e Elbasanit është një treg shumë përqendruar si pasojë e numrit të ndërmarrjeve të vogël të ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtari në këtë treg.
28. Nga analizimi i çmimeve mesatare mujore të aplikuara nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në qarkun e Elbasanit vërehet se çmimet e aplikuara nga ndërmarrjet për produktin beton për të gjitha markat janë të ndryshme nga njëra-tjetra dhe ritmi i ndryshimit të tyre është i ndryshëm, duke mos vërejtur shenja të caktimit të çmimeve apo koordinimit të tyre në ritmin e rritjes apo të zbritjes në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
29. Në përfundim të hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit konstatohet se: Pjesët e tregut të ndërmarrjeve janë të ndryshueshme nga viti në vit, pra nuk vërehet qëndrueshmëri në pjesët e tregut sipas sasisë dhe ka hyrje të reja në treg, duke zotëruar pjesë të konsiderueshme tregu për një periudhë të shkurtër si dhe çmimet mesatare mujore të e aplikuara nga ndërmarrjet për produktin beton, për të gjitha markat janë të ndryshme nga njëra-tjetra dhe ritmi i ndryshimit të tyre është i ndryshëm, duke mos vërejtur shenja të caktimit të çmimeve apo koordinimit të tyre në ritmin e rritjes apo të zbritjes në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 5, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbyllet e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të betonit në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi palëve të interesuara.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 977, Datë 26. 04. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË METRO FARMACI SHPK NGA SHOQËRIA DELTA HOLDING SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.04. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë METRO FARMACI SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit kontrollit të shoqërisë METRO FARMACI SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni në lidhje me përfimin e kontrollit të shoqërisë METRO FARMACI SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë Shitblerje Kuotash Kapitali”, nënshkruar më datë 27 shkurt 2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: DELTA HOLDING SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: themelimi, krijimi dhe administrimi i shoqërive dhe sipërmarrjeve shqiptare dhe të huaja si dhe pjesëmarrja në to; blerja apo disponimi mbi pjesëmarrjen në korporata, partneritete apo shoqëri e sindikata me objekte aktivitete të ndryshme; blerja, barrësimi, hipotekimi apo transferimi i pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme dhe titujve; konsulencë në fushën e investimeve të huaja dhe vendase etj.

DELTA HOLDING SHPK zotërohet 50% nga ortaku Z. Eduard Curraj dhe 50% nga ortaku Z. Dorian Sadiku.

Pala shitëse: Z. Dorian Sadiku, person fizik, shtetas shqiptar, zotërues i 100% të kuotave të shoqërisë target.

Shoqëria Target: METRO FARMACI SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ndërtime civile të të gjitha llojeve; aktivitete në fushën e ndërtimeve civile, zbatime dhe projektme, prodhime materiale inerte, gurë qeramikë etj; import, eksport, tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve farmaceutikë.

METRO FARMACI SHPK zotëron 90% të kotave në shoqërinë “Ditë e Natë” SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregtim medikamentesh, suplementesh, shtesash ushqimore, produkte kozmetike dhe medical device me pakicë etj. Shoqëria do të mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm tregtar import, eksporti, tregtia me shumicë e pakicë e mallrave etj.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë DELTA HOLDING SHPK (pala blerëse), Z. Dorian Sadiku (pala shitëse) dhe Znj. Jorida Jubani (dhënëse pëlqimi) është nënshkruar më datë 27 shkurt 2023 “Kontratë Shitblerjeje Kuotash Kapitali”.

Referuar kësaj kontrate, DELTA HOLDING SHPK do të blejë nga Z. Dorian Sadiku kuotën e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë target, METRO FARMACI SHPK, duke përfutur kontrollin e vetëm në shoqërinë target.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Tregu i barnave funksionon në zbatim të ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij. Për të kryer aktivitet ekonomik, subjektet që operojnë në tregtimin e barnave mjekësore, janë të detyruar të pajisjen me licenca profesionale për subjektet farmaceutike (fabrika, importues dhe tregtues me pakicë) për ushtrimin e veprimtarive respektive (fabrikim barnash, tregti me shumicë, farmaci) për barnat narkotike, psikotrope dhe prekursorët e kategorisë 1, e cila lëshohen nga QKB, referuar Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në zbatim të ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, tregtimi me shumicë i barnave kryhet nga importuesi, eksportuesi, shpërndarësi farmaceutik, që është person juridik ose fizik, tregtar, vendas ose i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për këtë veprimtari dhe tregtimi me pakicë i barnave kryhet nga farmacistë dhe agjencitë farmaceutike.

Nga informacioni i administruar gjatë procedurave të mëparshme në tregun e barnave, është konstatuar se ndërmarrjet farmaceutike që operojnë në rrjetin e shumicës dhe pakicës, krahas tregtimit të barnave, tregtojnë edhe suplemente ushqimore, vitamina, minerale, etj

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe

Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i barnave dhe suplementeve ushqimore dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Referuar informacionit të depozituar, shoqëria target nuk ka kryer aktivitet ekonomik gjatë vitit 2021, por nëpërmjet kontrollit të shoqërisë Ditë e Natë SHPK, ushtron influencë në tregun e shitjes më pakicë të barnave dhe suplementeve ushqimore, nëpërmjet një rrjeti të farmacive.

Shoqëria METRO FARMACI SHPK operon në këtë treg nëpërmjet rrjetit të farmacive Ditë e Natë, një rrjet farmaceutik, që përbëhet aktualisht nga 47 farmaci të shpërndara në të gjithë vendin, në Tiranë me 32 njësi dhe në qytete të tjera si: Shkodër 3 njësi, Durrës me 3 njësi, Elbasan 2 njësi, Vlorë 2 njësi dhe Lezhë e Korçë. Çdo farmaci mbulon shërbim 24 orësh.

Referuar të dhënave të administruara gjatë hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore (të dhëna nga FSDKSH), rezulton se kanë lidhur kontratë me Fondin 951 farmaci në të gjithë vendit nga të cilat 409 operojnë vetëm në qarkun e Tiranës dhe Kamëz-Vorë.

Sipas të dhënave të deklaruara nga pala njoftuese, shoqëria METRO FARMACI SHPK aktualisht zë më pak se 4% të tregut të shitjes me pakicë.

Duke qenë se shoqëria DELTA HOLDING SHPK nuk operon në tregun përkatës të produktit, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë METRO FARMACI SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 978, Datë 26. 04. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË AVICENA SHPK NGA SHOQËRIA DELTA HOLDING SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.04. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë AVICENA SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit kontrollit të shoqërisë AVICENA SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni në lidhje me përfutimin e kontrollit të shoqërisë AVICENA SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë Shitblerje Kuotash Kapitali”, nënshkruar më datë 27 shkurt 2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: DELTA HOLDING SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: themelimi, krijimi dhe administrimi i shoqërive dhe sipërmarrjeve shqiptare dhe të huaja si dhe pjesëmarrja në to; blerja apo disponimi mbi pjesëmarrjen në korporata, partneritete apo shoqëri e sindikata me objekte aktivitete të ndryshme; blerja, barrësimi, hipotekimi apo transferimi i pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme dhe titujve; konsulencë në

fushën e investimeve të huaja dhe vendase etj.

DELTA HOLDING SHPK zotërohet 50% nga ortaku Z. Eduard Curraj dhe 50% nga ortaku Z. Dorian Sadiku.

Pala shitëse: Z. Dorian Sadiku, person fizik, shtetas shqiptarë, zotërues i 80% të kuotave të shoqërisë target.

Shoqëria Target: AVICENA SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregtim me shumicë dhe pakicë të barnave, artikujve të ndryshëm farmaceutikë, medikamente, aktivitet importues pa përjashtuar shpërndarjen etj.

AVICENA SHPK zotërohet 80% nga Z. Dorian Sadiku dhe 20% nga Z. Enrik Zotaj.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë DELTA HOLDING SHPK (pala blerëse), Z. Dorian Sadiku (pala shitëse) dhe Znj. Jorida Jubani (dhënëse pëlqimi) është nënshkruar më datë 27 shkurt 2023 “Kontratë Shitblerjeje Kuotash Kapitali”.

Në përfundim të transaksionit, DELTA HOLDING SHPK do të zotërojë 80% shoqërinë target AVICENA SHPK.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Tregu i barnave funksionon në zbatim të ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij. Për të kryer aktivitet ekonomik, subjektet që operojnë në tregtimin e barnave mjekësore, janë të detyruar të pajisjen me Licensat profesionale për subjektet farmaceutike (fabrika, importues dhe tregtues me pakicë) për ushtrimin e veprimtarive respektive (fabrikim barnash, tregti me shumicë, farmaci) për barnat narkotike, psikotrope dhe prekursorët e kategorisë 1, e cila lëshohen nga QKB, referuar Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licensat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Tregtimi me shumicë i barnave kryhet nga importuesi, eksportuesi, shpërndarësi farmaceutik, që është person juridik ose fizik, tregtar, vendas ose i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për këtë veprimtari dhe tregtimi me pakicë i barnave kryhet nga farmacistë.

Nga informacioni i administruar gjatë procedurave të mëparshme në tregun e barnave, është konstatuar se ndërmarrjet farmaceutike që operojnë në rrjetin e shumicës dhe pakicës, krahas barnave, tregtojnë edhe suplemente ushqimore, vitamina, minerale, etj

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i barnave dhe suplementeve ushqimore dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në të dhënat e deklaruara nga pala njoftuese, shoqëria target operon në tregtimin me shumicë të barnave (importues dhe shpërndarës).

Pjesa më e madhe e barnave të tregtuara janë të importuar nga ndërmarrje importuese dhe për të vlerësuar

strukturën e tregut, u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshëm e Doganave.

Nga përpunimi i të dhënave të importit, rezultoi se shoqëria AVICENA SHPK ka realizuar importe të barnave gjate dy viteve të fundit, por me një pjesë shumë të vogël të tregut (sipas vlerës CIF të importit), [_____] për vitin 2021 dhe 2022. Struktura e tregut të importit të barnave i jep tregut karakteristikat e një tregu konkurrencial, ku indeksi i përqendrimit HHI është në nivelin [_____] për vitin 2021 dhe [_____] për vitin 2022.

Shoqëria DELTA HOLDING SHPK, nëpërmjet “Kontratë Shitblerje Kuotash Kapitali” të nënshkruar më datë 27 shkurt 2023, synon të përftojë edhe kontrollin e shoqërisë DELTA PHARMA-AL SHPK.

Transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë AVICENA SHPK nga shoqëria DELTA HOLDINGS SHPK nuk do të krijojë mbivendosje vertikale të palëve në tregun përkatës të produktit pasi blerësi nuk operon në tregun e shitjes me shumicë të barnave dhe suplementeve ushqimore, por do të sjellë efekte horizontale për shkak të ushtrimit të aktivitetit ekonomik në të njëjtin treg të dy shoqërive, targetit AVICENA SHPK dhe shoqërisë DELTA PHARMA-AL SHPK.

Referuar indeksit të përqendrimit para dhe pas përqendrimit, transaksioni nuk do të ketë efekte të ndjeshme në ndryshimin e strukturës së tregut pasi, shoqëria AVICENA SHPK zotëron një pjesë shumë të vogël të tregut dhe ndryshimi i Indeksit të Përqendrimit të tregut do të jetë i papërfillshëm.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë AVICENA SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 979, Datë 26. 04. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DELTA PHARMA – AL SHPK NGA SHOQËRIA DELTA HOLDING SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.04. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DELTA PHARMA – AL SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit kontrollit të shoqërisë DELTA PHARMA – AL SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni në lidhje me përfutimin e kontrollit të shoqërisë DELTA PHARMA – AL SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë Shitblerje Kuotash Kapitali”, nënshkruar më datë 27 shkurt 2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: DELTA HOLDING SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: themelimi, krijimi dhe administrimi i shoqërive dhe sipërmarrjeve shqiptare dhe të huaja si dhe pjesëmarrja në to; blerja apo disponimi mbi pjesëmarrjen në korporata, partneritete apo shoqëri e sindikata me objekte aktivitete të ndryshme; blerja, barrësimi, hipotekimi apo transferimi i pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme dhe titujve; konsulencë në

fushën e investimeve të huaja dhe vendase etj.

DELTA HOLDING SHPK zotërohet 50% nga ortaku Z. Eduard Curraj dhe 50% nga ortaku Z. Dorian Sadiku.

Pala shitëse: Z. Eduard Curraj, person fizik, shtetas shqiptar, zotërues i 100% të kuotave të shoqërisë target.

Shoqëria Target: DELTA PHARMA – AL SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: distribucionin dhe shpërndarjen e barnave dhe medikamenteve mjekësore; import eksport, tregti me shumicë dhe pakicë të barnave dhe medikamenteve mjekësore, barnave popullore, pajisjeve dhe aparaturave mjekësore, mjeteve dhe materialeve ndihmëse mjekësore etj.

DELTA PHARMA – AL SHPK zotëron 100% të shoqërisë DELTA PHARMA, e regjistruar në Republikën e Kosovës; 100% të shoqërisë DELTA PHARMA d.o.o e regjistruar në Bosnjë Hercegovinë dhe 28% SKOPSTER d.o.o. e regjistruar në Maqedoninë e Veriut.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë DELTA HOLDING SHPK (pala blerëse), Z. Eduard Curraj (pala shitëse) dhe Znj. Marjana Curraj (dhënëse pëlqimi) është nënshkruar më datë 27 shkurt 2023 “Kontratë Shitblerje Kuotash Kapitali”.

Referuar kësaj kontrate, DELTA HOLDING SHPK do të blejë nga pala shitëse, kuotën e cila përbën 100% të kapitalit të shoqërisë DELTA PHARMA - AL SHPK, duke përfutur kontrollin e vetëm mbi shoqërinë target.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Tregu i barnave funksionon në zbatim të ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij. Për të kryer aktivitet ekonomik, subjektet që operojnë në tregtimin e barnave mjekësore, janë të detyruar të pajisjen me Licensat profesionale për subjektet farmaceutike (fabrika, importues dhe tregtues me pakicë) për ushtrimin e veprimtarive respektive (fabrikim barnash, tregti me shumicë, farmaci) për barnat narkotike, psikotrope dhe prekursorët e kategorisë 1, e cila lëshohen nga QKB, referuar Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licensat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Tregtimi me shumicë i barnave kryhet nga importuesi, eksportuesi, shpërndarësi farmaceutik, që është person juridik ose fizik, tregtar, vendas ose i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për këtë veprimtari dhe tregtimi me pakicë i barnave kryhet nga farmacitë.

Nga informacioni i administruar gjatë procedurave të mëparshme në tregun e barnave, është konstatuar se ndërmarrjet farmaceutike që operojnë në rrjetin e shumicës dhe pakicës, krahas barnave, tregtojnë edhe suplemente ushqimore, vitamina, minerale, etj

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet

tregu i barnave dhe suplementeve ushqimore dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria Delta Pharma SHPK është regjistruar pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore si subjekt për importin dhe tregtimin me shumicë të barnave.

Pjesa më e madhe e barnave të tregtuara janë të importuar nga ndërmarrje importuese dhe për të vlerësuar strukturën e tregut, u administruan të dhënat e importit të barnave dhe suplementeve ushqimore.

Nga përpunimi i të dhënave rezultoi se tregu i importit të barnave ka karakteristikat e një tregu konkurrencial, ku indeksi i përqendrimit HHI është në nivelin [_____] për vitin 2021 dhe [_____] për vitin 2022 dhe shoqëria DELTA PHARMA-AL SHPK ka realizuar importe të barnave gjate dy viteve të fundit, duke u renditet e dyta në strukturën e tregut (sipas vlerës CIF të importit) me [_____] të tregut për vitin 2022.

Transaksioni i njoftuar do të sjellë përfitim e kontrollit të shoqërisë DELTA PHARMA-AL SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK .

Duke qenë se shoqëria DELTA HOLDING SHPK nuk operon në tregun përkatës të produktit, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë DELTA PHARMA-AL SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 980, Datë 26. 04.2023

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 961, datë 28.02.2023, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.04.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 961, datë 28.02.2023, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit”.

Bazë ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 42 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, “Mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit”,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 961, datë 28.02.2023, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit”, ka vendosur hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit për periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 31 Mars 2023, për të vlerësuar nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9121/2003, si dhe raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraprak, bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", me qëllim identifikimin e saktë të ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun objekt hetimi, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Nga informacioni i administruar nga AKU rezulton se, në tregun e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të qumështit në territorin e Republikës së Shqipërisë ushtrojnë veprimtari rreth 240 subjekte, ku janë të përfshirë dhe personat fizikë të cilët përpunojnë qumësht në zona të kufizuara gjeografike dhe me sasi shumë të vogla.
3. Në vijim të procedurës, bazuar në të dhënat e depozitura si më sipër, ka filluar kryerja e inspektive pranë ndërmarrjeve që zotërojnë pjesë të konsiderueshme të tregut të prodhimit, përpunimit dhe

tregtimit të qumështit në qytetin e Tiranës, Durrësit, Kavajës, Divjakës, Lushnjës, Fierit, Vlorës, Beratit, Krujës dhe Shkodrës.

4. Për shkak të numrit të lartë të inspektimeve pranë ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, shtrirjes gjeografike të vendndodhjes së tyre, sasisë së të dhënave që duhen përpunuar pas inspektimeve dhe kërkesave për informacion, është bërë i pamundur përfundimi i të gjitha procedurave hetimore dhe përgatitja e raportit të hetimit paraprak brenda afatit 2 (dy) mujor të përcaktuar.
5. Bazuar sa më sipër, për shkak të kohës jo të mjaftueshme të mbetur në dispozicion, me qëllim përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e një analize të plotë të sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, vlerësojmë të nevojshme zgjatjen e periudhës së hetimit paraprak me qëllim kryerjen e procedurave hetimore dhe përgatitjen e raportit.
6. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 961, datë 28.02.2023, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit”, afati i përcaktuar në pikën “III”, shtyhet me 3 (tre) muaj.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 981, Datë 11. 05. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË SAUDI ARAMCO DEVELOPMENT CO LTD. DHE EXCEL INVESTMENTS NETHERLANDS B.V.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.05. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Aramco Development Co Ltd. dhe Excel Investments Netherlands B.V.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Aramco Development Co Ltd. dhe Excel Investments Netherlands B.V.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Aramco Development Co Ltd dhe Excel Investments Netherlands B.V.

Referuar “Marrëveshjes së ortakëve”, palët janë:

Pala 1: Saudi Aramco Development Co Ltd. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me ortak të vetëm, e themeluar dhe që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, e angazhuar në furnizimin dhe tregtimin e naftës, gazit, petrokimike, shërbimet komunale dhe furnizime industriale.

Saudi Aramco Development Co Ltd. është një filial në pronësi të plotë të shoqërisë Saudi Arabian Oil

Company, shoqëri aksionare, e themeluar dhe që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, e angazhuar në kërkimin, eksplorimin, shpimin dhe nxjerrjen e substancave hidrokarbure dhe përpunimin, prodhimin, rafinimin dhe tregtimin e këtyre substancave.

Saudi Arabian Oil Company nuk ka prezencë ligjore të regjistruar në Shqipëri, por gjeneron të ardhura në Shqipëri përmes tregtimit dhe shitjes së hidrokarbureve dhe lëndëve të tjera derivate.

Pala 2: Excel Investments Netherlands B.V. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin e holandez, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve logjistike.

Excel Investments Netherlands B.V. është një filial i zotëruar në mënyrë indirekte nga Deutsche Post AG, shoqëria mëmë e Deutsche Post DHL Group, një grup global logjistik, i cili e ushtron aktivitetin nën dy marka (Deutsche Post dhe DHL).

Deutsche Post DHL Group është prezent në Shqipëri nëpërmjet filialit të tij DHL International (Albania) SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila ka si objekt të aktivitetit transportin me të gjitha mjetet: transport tokësor, detar, ujqor dhe ajror dhe kryerjen e çdo veprimtarie tregtare, industriale, financiare, pasurore, e cila lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin tregtar të shoqërisë.

Ndërmarrja e Përbashkët (JV), nuk është themeluar ende. Ajo do të themelohet në Mbretërinë e Arabisë Saudite si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i të cilës do të jetë:

- a) Të zhvillojë, operojë dhe mirëmbajë objektet për ofrimin e shërbimeve në zonën gjeografike të Arabisë Saudite dhe Rajon;
- b) Të tregtojë, zhvillojë, shesë dhe ofrojë shërbime në zonën gjeografike;
- c) Të kryejë aktivitete kërkimore dhe zhvillimore në lidhje me shërbimet.

Aktualisht nuk ka plane që ndërmarrja e përbashkët (JV) të jetë aktive, apo të ushtrojë aktivitet në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Më datë 20 mars 2023 është nënshkruar “Marrëveshje ortakësh” ndërmjet Saudi Aramco Development Co Ltd. dhe Excel Investments Netherlands B.V., në lidhje me krijimin e një sipërmarrje të përbashkët të shërbimeve të zinxhirit të furnizimit në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

Saudi Aramco Development Co Ltd. do të ketë një pjesë fillestare të kapitalit të barabartë me 49% dhe Excel Investments Netherlands B.V. do të ketë një pjesë fillestare të kapitalit të barabartë me 51% të kapitalit.

Referuar marrëveshjes, si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu për kontraktimin e shërbimeve logjistike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët Joint-Venture me funksione të plota nga shoqëria Saudi Aramco Development Co Ltd. dhe shoqëria Exel Investments Netherlands B.V., e cila do të zotërohet 49% nga shoqëria Saudi Aramco Development Co Ltd. dhe 51% nga

shoqëria Exel Investments Netherlands B.V.

Shoqëria J-V do të krijohet në Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe nuk ka plane që ajo të jetë aktive në Shqipëri.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Aramco Development Co Ltd. dhe shoqëria Exel Investments Netherlands B.V.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 982, Datë 11. 05. 2023

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË ASETEVE TË SHOQËRISË BREEZE TWO ENERGY GMBH & CO.KG, NGA SHOQËRIA STATKRAFT GERMANY GMBH”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 05. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aseteve të shoqërisë Breeze Two Energy GmbH & Co.KG, nga shoqëria Statkraft Germany GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aseteve të shoqërisë Breeze Two Energy GmbH & Co.KG, nga shoqëria Statkraft Germany GmbH.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi transaksionin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aseteve të shoqërisë Breeze Two Energy GmbH & Co.KG, nga shoqëria Statkraft Germany GmbH.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, palët janë:

Pala blerëse: Statkraft Germany GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit gjerman, regjistruar sipas regjistrimit tregtar të Gjykatës së Rrethit të Düsseldorfit, me objekt aktiviteti: Blerja, veprimtaria holding, administrimi dhe shitja e aksioneve në shoqëri të tjera dhe kryerja e të gjitha aktiviteteve të ndërlidhura me to. Statkraft Germany GmbH është pjesë e Grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria

Statkraft Markets B.V: *Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devoll Hydropower SHA.*

Shoqëritë Target: Shoqëritë target përfshijnë portofolin gjerman të shitësit (tridhjetë e pesë ferma për energjinë nga era) dhe portofolin francez të shitësit (katër ferma për energjinë nga era), nuk janë prezente dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.

Pala shitëse: Breeze Two Energy GmbH & Co.KG është një partneritet i kufizuar, i themeluar sipas ligjeve të Gjermanisë. Linja e biznesit të shoqërisë përfshin prodhimin, transmetimin dhe/ose shpërndarjen e energjisë elektrike.

II. Përqendrimi

Referuar dokumentacionit zyrtar të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, rezulton se shitësi zotëron një portofol të fermave për energjinë nga era të vendosura kryesisht në Gjermani dhe disa prej tyre në Francë.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e drejtpërdrejtë, nëpërmjet një marrëveshjeje, të të gjitha kuotave në pronësi të shitësit, në një Shoqëri të Re (Target nr. 1), në të cilin të gjitha asetet gjermane të shitësit do të transferohen përpara nënshkrimit të SPA dhe të filialit të tij francez (Target nr.2).

Në varësi të përmbajtjes së SPA, transaksioni synon të marrë kontrollin e plotë të dy shoqërive target.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e propozuar të aseteve të shoqërisë Breeze Two Energy GmbH & Co.KG, nga shoqëria Statkraft Germany GmbH, e cila do të bëhet efektive me nënshkrimin e Marrëveshjes.

Referuar dokumentacionit si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Në zbatim të nenit 60 pika 1 të ligjit 9121/2003, pala njoftuese ka kërkuar Autorizimin e Përqendrimit të Përkohshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët.

Përqendrimi i njoftuar pritet të mos krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Autoriteti i Konkurrencës gjykon të nevojshëm dhënien e autorizimit të përqendrimit të përkohshëm deri në depozitimin e marrëveshjes së nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të aseteve të shoqërisë Breeze Two Energy GmbH & Co.KG, nga shoqëria Statkraft Germany GmbH.
- II.** Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
- III.** Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- IV.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 983, Datë 11. 05. 2023

“PËR PËRJASHTIMIN NGA NDALIMI TË MARRËVESHJES SË LIDHUR NDËRMJET SHOQËRIVE PHILIP MORRIS PRODUCTS S.A DHE KT&G CORPORATION”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11. 05. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 5, neni 6, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve”; Rregullorja “Për Përjashtimin në Bllok të Kategorive të Marrëveshjeve Vertikale dhe Praktikave të Bashkërenduara”; Rregullorja “Për kategoritë e Marrëveshjeve të Specializimit”; Udhëzimi “Për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Studimit të Tregjeve “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation”,

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur:

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar kërkesa për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.

Palët njoftuese kanë depozituar dokumentacion e kërkuar në zbatim të nenit 49 të ligjit dhe Udhëzimi “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve”.

Referuar marrëveshjes së lidhur në datë 30 Janar 2023, palët në marrëveshje janë:

KT&G Corporation (KT&G) është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit korean, me objekt aktiviteti: prodhimin dhe shitjen e cigareve dhe materialeve në lidhje me to, prodhimin dhe shitjen e ushqimeve dhe pijeve dhe gjithashtu është e specializuar në fushën e biofarmaceutikes dhe produkteve të bukurisë.

KT&G Corporation nuk është aktualisht aktive në Shqipëri.

Philip Morris Products S.A (PMI) është një shoqëri anonime, e themeluar sipas ligjeve të Zvicrës, me objekt aktiviteti: prodhimin dhe shitjen e produkteve të duhanit, i të gjitha produkteve që përmbajnë nikotinë dhe i pajisjeve dhe aksesorëve që lidhen me to.

Philip Morris Products S.A është prezente në Shqipëri përmes shoqërisë Philip Morris Albania SHPK. Philip Morris Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: blerjen, shitjen, importin dhe eksportin e produkteve të duhanit dhe mallrave të tjera të konsumit, përfshirë pajisjet elektrike.

II. Marrëveshjet

Marrëveshja Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë, parashikon që të gjitha detyrimet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin dhe shpërndarjen e produkteve të KT&G nga PMI do të jenë pjesë integrale e saj, si dhe do të rregullojë ekskluzivisht kushtet sipas së cilave shërbimet ofrohen dhe produktet prodhohen, paketohen dhe furnizohen tek PMI dhe/ose Filialet e saj, dhe asnjë kusht tjetër nga KT&G ose ndonjë palë e tretë nuk do të zbatohet për këto shërbime ose për furnizimin, prodhimin, paketimin dhe dërgimin e Produkteve.

Bazuar në nenin 2 “Emërimi i Shpërndarësit Ekskluziv” dhe nenin 3 “Tregtimi i Platformave të Portofolit” të “Marrëveshjes Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë”, KT&G do t’i japë PMI-së të drejta ekskluzive, si distributor ekskluziv, për të tregtuar *produktet e platformës së portofolit* të KT&G, i cili përfshin pajisjen specifike KT&G, materiale konsumi dhe aksesorët KT&G, në tregjet jashtë Republikës së Koresë së Jugut dhe Rusisë. PMI do të tregtojë dhe do të shpërndajë gjatë gjithë kohës Produktet e secilës Platformë Portofoli, të zgjedhur prej saj në përputhje me kushtet e Marrëveshjes.

Kohëzgjatja e dispozitave të ekskluzivitetit dhe të detyrimeve jo-konkurruese është në përputhje me “Marrëveshjen Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë”, për një periudhë fillestare prej pesë vjetësh, me synim zgjatjen e afatit për një periudhë të njëpasnjëshme pesë (5) vjeçare.

Referuar nenit 7, të “Marrëveshjes Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë”, PMI do të ndërmarrë angazhime të konsiderueshme vëllimore për materialet e konsumueshme, të cilat do të sigurojnë furnizimin e vazhdueshëm të produkteve KT&G, në tregjet jashtë Republikës së Koresë së Jugut dhe Rusisë.

Palët do të ruajnë të drejtat ekskluzive përkatëse për të drejtat e ndërlidhura të pronësisë intelektuale dhe markat tregtare të KT&G, të nevojshme për të tregtuar Platformat e Portofolit sipas “Marrëveshjes Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë”.

PMI do të ketë të drejtën të importojë, eksportojë, shfrytëzojë, mbajë, tregtojë, dhe/ose të shpërndajë produktet e platformave të portofolit në tregje.

PMI dhe KT&G, do të krijojnë një Komitet Drejtues për të diskutuar çështje të tilla si përmirësimet e

kërkuara nga PMI, në Platformat e Portofolit të KT&G.

PMI do të ketë të drejtën e shprehur dhe të vetme për të marrë të gjitha vendimet tregtare në lidhje me platformat e portofolit në tregje, duke përfshirë planet e marketingut, shitjet në internet, kanalet, çmimet dhe, në varësi të Udhëzimeve të Markës siç janë planifikuar në “Marrëveshjen për Licencën e Markës Tregtare”, mjete e marketingut.

Marrëveshja për Licencën e Markës Tregtare dhe të drejtat e dhëna PMI-së në lidhje me PI-në (Pronësia Intelektuale) e markës KT&G, do të ekzistojnë paralelisht, por të pavarura nga “Marrëveshjes Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë”, në mënyrë që kjo e fundit të skadojë ose të përfundojë, por që kjo Marrëveshje dhe të drejtat e dhëna PMI-së, sipas saj do të vazhdojnë për afatin e mbetur në fuqi të kësaj Marrëveshje (subjekt i çdo rinovimi) dhe për sa më sipër, Palët dëshirojnë të lidhin këtë “Marrëveshje për Licencën e Markës Tregtare”, si një nga dokumentet e transaksionit.

Referuar nenit 2.1 dhe 3.1 “Të drejtat Ekskluzive” të “Marrëveshjes për Licencën e Markës Tregtare”, KT&G do t’i japë PMI-ë të drejta ekskluzive për markat e saj më qëllim tregtimin e produkteve KT&G.

Palët gjithashtu kanë përcaktuar në “Marrëveshjen për Licencën e Markës Tregtare”, një afat bashkëpunimi, për një periudhë fillestare prej (15) vjetësh. KT&G nuk do të jetë në gjendje ti shfrytëzojë ato marka gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes për Licencën e Markës Tregtare dhe për një periudhë të shkurtër pas përfundimit të saj.

Në varësi të përjashtimeve në Marrëveshjet Kalimtare, të drejtat e ekskluzivitetit të përcaktuara më sipër do të zbatohen nga data e hyrjes në fuqi deri skadimin ose përfundimin e afatit të licencës.

Gjithashtu do të ketë të drejtën të tregtojë çdo produkt të ri “smoke-free”, bazuar në sistemet e teknologjisë që KT&G zhvillon në të ardhmen, duke përfshirë cigaret elektronike, me kusht që palët të bien dakord për këtë qëllim më tej në procedurën e së drejtës së ofertës së parë.

Referuar “**Marrëveshjes së Shërbimit për Furnizimin dhe Logjistikën**”, objekti dhe zbatimi i kësaj Marrëveshje është i kufizuar në furnizimin e produkteve dhe shërbimeve nga KT&G për PMI -në dhe vendosjen e kuadrit për të drejtën e PMI-së, për të bashkëpakeluar produktet.

III. Baza ligjore

Përjashtimi nga ndalimi i marrëveshjeve vlerësohet në zbatim të nenit 5 të ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në të cilin parashikohet përjashtimin individual i marrëveshjeve nga zbatimi i nenit 4 të ligjit.

Neni 4 i ligjit ndalon të gjitha marrëveshjet të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg.

Marrëveshjet përjashtohen nga ndalimet e nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 në rastet kur kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit ose të shpërndarjes së produkteve ose në nxitjen e progresit teknologjik apo ekonomik nëse një pjesë e mjaftueshme e këtyre përfitimeve shkon në favor të klientëve dhe të konsumatorëve dhe kur:

1. Nuk përmban kufizime të veprimtarive të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, që nuk janë të domosdoshme për të arritur objektivat e sipërpërmendur;
2. Nuk kufizon, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në lidhje me produktet apo shërbimet, objekt i këtyre marrëveshjeve.

Procedurat e përjashtimit të një marrëveshje nga ndalimi janë parashikuar në Seksionin II të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (nenet 48-52), ndërkohë që aktet nënligjore përfshijnë: Udhëzimin “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve”; Rregulloren “Për kategoritë e Marrëveshjeve të Specializimit”; Rregulloren “Për Përjashtimin në Bllok të Kategorive të Marrëveshjeve Vertikale dhe Praktikave të Bashkërenduara” dhe Udhëzimin “Për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”.

Marrëveshjet e njoftuara rezultojnë në një marrëdhënie komplekse biznesi në formën e një marrëveshje horizontale mes konkurrentësh, të cilët ofrojnë të drejta ekskluzive në një nivel tjetër tregtimi (shpërndarje), marrëdhënie vertikale, përcaktojnë dhënien e të drejtës së pronësisë intelektuale për produktet, realizojnë prodhim të përbashkët, rregullojnë marrëdhëniet në fushën kërkim-zhvillimit duke i dhënë marrëveshjes elementet e një marrëveshje specializimi.

Nga vlerësimi i marrëveshjeve është konstatuar se dhënia e ekskluzivitetit, duke emëruar PMI si shpërndarës ekskluziv të produkteve të KT&G, përbën thelbin e marrëveshjeve. Dispozitat e tjera nëpërmjet të cilës, KT&G transferon ose i jep PMI të përdorë të drejtat e pronësisë intelektuale, apo marrëdhëniet e kërkim zhvillimit, nuk përbëjnë qëllimin parësor të marrëveshjes dhe lidhen drejtpërdrejtë me shpërndarjen e produkteve të dakortësuara.

Palët në marrëveshje kanë bërë vetëvlerësimin e përputhshmërisë së marrëveshjes ligjin nr. 9121/2003 dhe Rregulloren “Për Përjashtimin në Bllok të Kategorive të Marrëveshjeve Vertikale dhe Praktikave të Bashkërenduara”, duke evidentuar se marrëveshja është në përputhshmëri të plotë me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Udhëzimin “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve” dhe Rregulloren “Për Përjashtimin në Bllok të Kategorive të Marrëveshjeve Vertikale dhe Praktikave të Bashkërenduara” dhe për këtë arsye kërkojnë nga Autoriteti i Konkurrencës konfirmimin mbi këtë përputhshmëri.

Mbështetur në Udhëzimin e Komisionit të Konkurrencës “Për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”, Marrëveshja Kuadër (bashkë me marrëveshjet e tjera) klasifikohet si një marrëveshje vertikale e tregtimit pasi ka qëllim shitjen me shumicë të produkteve pa djegie që përmbajnë nikotinë.

IV. Analiza e konkurrencës

Në bazë të nenit 3, pika 7 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës përbëhet nga tregut përkatës i produktit dhe tregu përkatës gjeografik. Përcaktimi i tregut përkatës, si në atë të produktit dhe në atë gjeografik, ka një ndikim vendimtar në vlerësimin e strukturës së tregut dhe sjelljes së konkurrentëve në treg.

Që nga nënshkrimi i Marrëveshjeve origjinale, janar 2020, PMI ka hedhur në treg produktet “smoke - free” të KT&G në mbi 30 vende në mbarë botën, përkatësisht në Evropë, Azi Qëndrore, Azi, Amerika Jugore dhe Qendrore dhe Lindjen e Mesme. PMI do të kontribuojë me burimet, njohuritë dhe infrastrukturën e saj për tregjet ndërkombëtare, duke u dhënë konsumatorëve për herë të parë qasje ndaj produkteve “smoke-free” të KT&G, duke përshpejtuar arritjen e vizionit të PMI për një të ardhme “smoke-free”, duke bërë të mundur që KT&G të përfitojë nga eksperiencia teknike, shkencore dhe ndërkombëtare për të ndihmuar duhanpirësit e rritur të kalojnë në alternativa më të mira.

Përveç produkteve LIL dhe FIIT që shpërndahen nga PMI, KT&G tregton aktualisht në Shqipëri, cigaret e saj në tregun shqiptar (d.m.th. produkte duhani konvencionale, të djegshme, markat ESSE dhe PINE).

Në Shqipëri, produktet konvencionale të duhanit (dhe veçanërisht cigaret) përfaqësojnë pjesën më të rëndësishme të tregut të produkteve që përmbajnë nikotinë. Produktet alternative/produktet pa djegie që përmbajnë nikotinë janë një segment i tregut në zhvillim, me dinamizëm dhe inovacion të vazhdueshëm, krahasuar me produktet konvencionale. Ekzistojnë ngjashmëri dhe ndryshime të produkteve pa djegie që përmbajnë nikotinë dhe produkteve konvencionale të duhanit, me një trend të rritjes së vizibilitetit/pranisë së tyre në treg dhe kalimit nga produktet konvencionale në ato alternative nga konsumatorët.

Nga këndvështrimi i kërkesës, çdo shkallë e zëvendësueshmërisë midis produkteve “smoke-free” dhe produkteve tradicionale të djegshme të duhanit është e kufizuar dhe asimetrike, pasi përdoruesit e produkteve të djegshme mund të kalojnë në produktet “smoke-free”, por këta të fundit nuk do të kalojnë domosdoshmërisht te cigaret tradicionale. Për këtë arsye, furnizuesit e produkteve “smoke-free”, duhet të konkurrojnë me produktet tradicionale të djegshme për sa i përket çmimit, cilësisë, shijes, lehtësisë së përdorimit etj, ndërsa furnizuesit e produkteve tradicionale të djegshme nuk përballen me të njëjtat kufizime konkurruese lidhur me produktet “smoke-free”.

Nga këndvështrimi i ofertës, produktet “smoke-free”, të tilla si produktet e duhanit me ngrohje ose cigaret elektronike, kërkojnë njohuri të konsiderueshme si dhe investime të konsiderueshme kërkimore dhe zhvillimore. PMI ka realizuar më shumë se 10.5 miliardë dollarë investime në këtë kategori produktesh deri më sot.

Referuar analizës së tregut përkatës, në raportin e vlerësimit të përjashtimit nga ndalimi të kësaj marrëveshje, tregu përkatës i produktit do të përcaktohet *tregu i shitjes me shumicë të produkteve pa djegie që përmbajnë nikotinë* dhe tregu përkatës gjeografik do të përcaktohet *territori kombëtar i Republikës së Shqipërisë*.

Bazuar në vlerësimet e brendshme të PMI konstatohet se tregu i produkteve pa djegie, është një treg shumë i vogël krahasuar në tregun e shitjes së cigareve tradicionale, duke zënë gjatë vitit 2022 rreth 4% të gjithë tregut të cigareve. Pjesa e tregut e produkteve pa djegie të PMI dhe KT&G është 2.8% ndërkohë që në tregun e cigareve tradicionale pjesa e tregut e produkteve të PMI është 37.7%, me konkurrentë të afërt KARELIA TABACCO.

Lidhja e marrëveshjeve nuk do të ndikojë aktivitetin ekonomik të PMI, e cila do të ruajë portofolin e saj të gjerë të alternativave ndaj produkteve konvencionale të duhanit dhe do të vazhdojë të paraqesë një gamë të gjerë të konsumatorëve me shije, çmime dhe zgjedhje të ndryshme teknologjike për të inkurajuar kalimin e tyre drejt produkteve “smoke-free”.

Nëpërmjet këtij transaksioni, konsumatorët e produktit “smoke-free” të KT&G do të përfitojnë nga eksperiencia e PMI-së, rrjeti tashmë i konsoliduar i shpërndarjes dhe mbështetja e shitjeve post-blerje, një cilësi më të mirë shërbimi.

Marrëveshjet e lidhura mes palëve do të sjellin rezultate pozitive për sa i përket konkurrencës, pasi PMI do të vazhdojë të zgjerojë shitjen e produkteve “smoke-free” të KT&G jashtë Republikës së Koresë, duke rritur markën ndërkombëtare të kësaj të fundit dhe duke zhvilluar praninë e saj në treg në shumë juridiksione. PMI do të kontribuojë me burimet, eksperiencën dhe infrastrukturën e saj për të ruajtur përfitimet e arritura në rrjedhën e marrëdhënieve ekzistuese strategjike të palëve dhe do të ndihmojë në sigurimin e konsumatorëve në juridiksione shtesë për të parën herë aksesin në produktet “smoke-free” të KT&G, duke përshpejtuar kështu arritjen e PMI-së për të realizuar vizionin e një të ardhmeje “smoke-

free”.

Marrëveshja Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë, Marrëveshja për Licencën e Markës Tregtare dhe Marrëveshja e Shërbimit për Furnizimin dhe Logjistikën nuk çon në parandalimin, kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në tregun përkatës duke mos qenë marrëveshje kufizuese sipas nenit 4/1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Në zbatim të Rregullores “Për Përjashtimin në Bllok të Kategorive të Marrëveshjeve Vertikale dhe Praktikave të Bashkërenduara” dhe Udhëzimit “Për vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”, analiza e efekteve që këto marrëveshje do të kenë në tregun e shitjes me shumicë të produkteve pa djegie që përmbajnë nikotinë, do të vlerësohet për një periudhë kohore 2 vjeçare.

Për sa më sipër, ky njoftim nuk përmban kufizime të veprimtarisë së ndërmarrjeve pjesëmarrëse dhe nuk kufizon konkurrencën në lidhje me produktet objekt i marrëveshjeve. Këto marrëveshje do të ndihmojnë në rritjen e prodhimit, gjenerimin e efekteve pozitive për konsumatorët dhe konkurrencën në tregun shqiptar në përgjithësi, duke përfshirë një përzgjedhje më të gjerë dhe me më shumë alternativa në produktin e cigareve pa djegie, zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes dhe do të rrisin mundësinë e zgjedhjeve konsumatore për produkte të reja.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 50 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të përjashtojë nga ndalimi “Marrëveshjen Kuadër për Tregtimin dhe Licencën e Teknologjisë”, “Marrëveshjen për Licencën e Markës Tregtare” dhe “Marrëveshjen e Shërbimit për Furnizimin dhe Logjistikën”, të lidhura ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe KT&G Corporation.
2. Afati i përjashtimit të marrëveshjeve të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 984, Datë 11.05.2023

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NDAJ NDËRMARRJES
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK NË TREGUN E SHËRBIMIT TAKSI PËR
UDHËTARË NGA DHE DREJT AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.05.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapja e procedurës së hetimit paraparak ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.

Baza Ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26, neni 42, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenin 28, germa (a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka monitoruar tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
2. Nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit të tregut të shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, u konstatua se, në zonën e jashtme të mbërritjeve (ose ndryshe zona Kiss&Fly) e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, nëpërmjet një tabele me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, nuk lejohet aksesimi nga ndërmarrje të tjera të ofrojnë shërbimin e taksive për udhëtarë nga aeroporti drejt Tiranës të cilët nuk kanë pasagjerë brenda. Ky akses lejohet vetëm për taksitë e ndërmarrjes Auto Holiday Albania.
3. Tirana International Airport SHPK zotëron pozitë dominuese, pasi është i vetmi subjekt i cili ofron facilitetet esenciale në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës.

4. Për sa më sipër, vlerësojmë se, mund të jemi para shkeljes së nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ku përcaktohet se përbën abuzim nga ana e një ndërmarrje me pozitë dominuese refuzimi për të ofruar shërbime/produkte duke i vendosur ato në kushte të pabarabarta konkurrence.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

- I.** Hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
- II.** Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 11 maj 2023.
- III.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 985, Datë 24. 05. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË SHANGHAI MUCHUAN INDUSTRIAL DESIGN CO., LTD NGA SHOQËRIA CARIAD ESTONIA AS.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24. 05. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Shanghai Muchuan Industrial Design Co., Ltd nga shoqëria CARIAD Estonia AS.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Shanghai Muchuan Industrial Design Co., Ltd nga shoqëria CARIAD Estonia AS.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Shanghai Muchuan Industrial Design Co., Ltd nga shoqëria CARIAD Estonia AS.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shit-blerje kuotash”, të nënshkruar më datë 03 mars 2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: CARIAD Estonia AS është një shoqëri publike e kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Estonisë. CARIAD Estonia AS është një nga qendrat ndërkombëtare për kompaninë e softuerit të automobilave të Grupit Volkswagen. Shoqëria gjithashtu kryen aktivitete të tjera profesionale, shkencore dhe teknike. CARIAD Estonia AS është një filial i zotëruar plotësisht nga

CARIAD SE, një filial i zotëruar plotësisht nga shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft.

Volkswagen Aktiengesellschaft (VWAG), është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt veprimtarie: Prodhimi dhe shitja e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, pjesëve të tyre si dhe të gjitha sistemeve, makinerive, veglave dhe produkteve të tjera teknike. Shoqëria gjithashtu mund të krijojë degë brenda dhe jashtë vendit, të themelojë ose të blejë shoqëri të tjera ose të marrë pjesë/investojë në shoqëri të tilla.

Volkswagen Aktiengesellschaft është shoqëria mëmë e Volkswagen Group, e cila është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve të mëposhtme:

Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.

Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesoreve, etj.

Palët shitëse:

Personat fizik: Z.Wenxin Zhang , Z. Xinlei Wang, dhe Z. Lei Teng, banues në Republikën Popullore të Kinës.

Shenzhen Hongtai Growth Entrepreneur Investment LLP, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Republikës Popullore të Kinës, ortakëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shanghai Zhoudao Intelligent Technology LLP, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Republikës Popullore të Kinës, ortakëri me përgjegjësi të kufizuar.

Beijing Zcool Network Technology Co., Ltd., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Professional Regulation Commission (PRC).

Shenzhen Runyuan Investment LLP, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Republikës Popullore të Kinës, ortakëri me përgjegjësi të kufizuar.

Fujian Biaorun Investment LLP, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Republikës Popullore të Kinës, ortakëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria Target: Shanghai Muchuan Industrial Design Co.,Ltd., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit Republikës Popullore të Kinës, me objekt aktiviteti: Angazhim në zhvillimin e teknologjisë, transferimin e teknologjisë, këshillimin e teknologjisë dhe shërbimet teknologjike në fushat e teknologjisë së dizajnit industrial, teknologjisë së pajisjeve inteligjente, teknologjisë së rrjetit, teknologjisë së produkteve dixhitale dhe teknologjisë së produkteve elektronike, planifikimit të imazhit të korporatës, dizajnit grafik të prodhimit, dizajnit të produktit, etj, shitje të pajisjeve inteligjente, produkte dixhitale, produkte elektronike, kompjuter, softuer dhe pajisje

kompjuterike,.

Shoqëria Target nuk është e pranishme dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Ndërmjet CARIAD Estonia AS (blerësi), Z.Wenxin Zhang, Z. Xinlei Wang, Z. Lei, Shenzhen Hongtai Growth Entrepreneur Investment LLP, Shanghai Zhoudao Intelligent Technology LLP, Beijing Zcool Network Technology Co., Ltd., Shenzhen Runyuan Investment LLP, Fujian Biaorun Investment LLP (shitësit) dhe shoqërinë Shanghai Muchuan Industrial Design Co.,Ltd. (target), është lidhur Marrëveshje shit-blerje kuotash”, më datë 03 mars 2023.

Referuar termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshjeje, kjo marrëveshje është lidhur më qëllim blerjen e 100% të kapitalit, të shoqërisë Shanghai Muchuan Industrial Design Co.,Ltd. nga shoqëria CARIAD Estonia AS.

Në datën e lidhjes së kësaj marrëveshje shoqëria Shanghai Muchuan Industrial Design Co.,Ltd., zotëron plotësisht edhe kapitalin e shoqërisë Beijing Muchuan Industrial Design Co., Ltd, që bashkërisht referohen si shoqëritë e grupit.

Referuar dokumentacionit si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu për zgjidhjet softuerike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

CARIAD Estonia AS zotërohet nga CARIAD SE, i cili është një filial në pronësi të plotë të Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG), ndërmarrja mëmë e Grupit Volkswagen. Grupi VW operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK, në tregun e shitjes së automjeteve dhe në tregun e qerasë financiare e sigurime.

Shanghai Muchuan Industrial Design Co., Ltd. ofron kryesisht shërbime të projektimit të ndërfaqeve njerëzore dhe shërbime të caktuara plotësuese. Target nuk është aktiv dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri. Aktiviteti i tij fokusohet te klientët kinezë të automjeteve.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Shanghai Muchuan Industrial Design Co., Ltd nga shoqëria CARIAD Estonia AS.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 986, Datë 24. 05. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE PEEL NRE WIND FARMS (YELL) LIMITED DHE PEEL NRE WIND FARMS (NO.1) LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT UK LTD”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24. 05. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes të aksioneve të shoqërisë Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.

Bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, me vendimin nr. 968, datë 24.03.2023, “Mbi autorizimin e përqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.”, vendosi:

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitohet pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Në zbatim të pikës 3 të vendimit nr. 968, me shkresën nr. 168/5, datë 08.05.2023 “Njoftim përqendrimi dhe kërkesë për autorizim të përqendrimit”, jemi njoftuar se shoqëria Statkraft UK Ltd ka lidhur marrëveshjen për blerje aksionesh të shoqërive Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerje aksionesh”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Statkraft UK Ltd, është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit anglez. Statkraft UK LTD është e angazhuar në biznesin e zhvillimit dhe operimit të projekteve të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, gjenerimit dhe tregtimit të energjisë elektrike dhe të furnizimit me energji.

Statkraft UK LTD është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS (shoqëria mëmë, e fundit e grupit Statkraft), një shoqëri lider në sektorin e hidroenergjisë dhe aktori më i madh i hidroenergjisë së rinovueshme në Evropë. Statkraft AS është plotësisht në pronësi të shtetit norvegjez.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

- *Statkraft Renewables Albania SHPK*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt veprimtarie: Veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj, dhe
- *Devoll Hydropower SHA*, është një shoqëri aksionare, me objekt veprimtarie: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësive prodhuese hidroelektrike në Luginën e Devollit, si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Shoqëritë Target:

- **Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Anglisë, me objekt aktiviteti: zhvillimin e dy fermave të prodhimit të energjisë nga era në Ishujt Shetland në Mbretërinë e Bashkuar.
- **Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar, sipas legjislacionit të Anglisë, me objekt aktiviteti: zhvillimin e dy fermave të prodhimit të energjisë nga era në Ishujt Shetland në Mbretërinë e Bashkuar.

Shoqëritë Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited, zotërohen 100% nga shoqëria Peel NRE Renewables (IOM) Limited. Shoqëritë Target nuk janë prezent dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri.

Pala shitëse: Peel NRE Renewables (IOM) Limited, është një shoqëri e kufizuar në aksione, e regjistruar në Isle of Man.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Statkraft UK Ltd dhe shoqërisë Peel NRE Renewables (IOM) Limited, është lidhur “Marrëveshje për blerje aksionesh”, e nënshkruar datë 18 prill 2023.

Referuar kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë marrëveshje, shitësi Peel NRE Renewables (IOM) Limited i shet blerësit Statkraft UK Ltd, me garanci të plotë të titullit dhe pa asnjë barrë aksionet dhe blerësi blen aksionet nga shitësi.

Aksionet përbëjnë tërësinë e kapitalit aksionar të alokuar dhe të emetuar të shoqërive target, të cilat janë paguar plotësisht. Shitësi është i angazhuar në një proces shitje në ankand nëpërmjet këshilltarëve të tij financiar të projekteve të fermave të erës dhe blerësi është zgjedhur pas këtij procesi si ofertues i preferuar. Blerësi do të blejë të gjitha aksionet e zotëruara nga shitësi tek shoqëritë target.

Transaksioni i propozuar, konsiston në përfitim të kontrollit, nëpërmjet blerjes së aksioneve në shoqërinë Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe shoqërinë Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft IH Holdings AS.

Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime jo-konvecionale, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nuk janë prezente dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri. Ato janë të angazhuara në zhvillimin e dy fermave të prodhimit të energjisë nga era në Ishujt Shetland në Mbretërinë e Bashkuar.

Blerësi dhe Target janë aktivë në tregun e zhvillimit të projekteve të energjisë nga burime jo-konvecionale në Mbretërinë e Bashkuar.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes të aksioneve të shoqërisë Peel NRE Wind Farms (Yell) Limited dhe Peel NRE Wind Farms (No.1) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 987, Datë 24.05.2023

“PËR MARRJEN E MASËS SË PËRKOQSHME PËR RIVENDOSJEN E KONKURENCËS NË TREGUN E SHËRBIMIT TAKSI PËR UDHËTARË NGA DHE DREJT AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.05.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.

Baza Ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 44, pika 1 dhe 2 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”,

VËREN SE :

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenin 28, germa (a), të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka monitoruar tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
2. Nga vlerësimi i informacionit gjatë monitorimit të tregut të shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, u konstatua se, në zonën e jashtme të mbërritjeve (ose ndryshe zona Kiss&Fly) e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, nëpërmjet një tabele sinjalistike nuk lejohet aksesimi nga ndërmarrje të tjera të ofrojnë shërbimin e taksive për udhëtarë nga aeroporti drejt Tiranës të cilët nuk kanë pasagjerë brenda. Ky akses lejohet vetëm për taksitë e ndërmarrjes Auto Holiday Albania.
3. Tirana International Airport SHPK zotëron pozitë dominuese, pasi është i vetmi subjekt i cili ofron facilitetet esenciale në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës.

4. Për sa më sipër, vlerësojmë se, mund të jemi para shkeljes së nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ku përcaktohet se përbën abuzim nga ana e një ndërmarrje me pozitë dominuese refuzimi për të ofruar shërbime/produkte duke i vendosur ato në kushte të pabarabarta konkurrence.
5. Si përfundim, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 9121/2003, referuar sjelljes së ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, vlerësojmë se jemi përpara një rasti urgjence për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën në këtë treg, pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenin 44, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

VENDOSI:

- I. Marrjen e masës së përkohshme ndaj ndërmarrjes Tirana International Airport SHPK në tregun e shërbimit taksi për udhëtarë nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, si vijon:
 - a. Lejimin e aksesit pa kushte për të gjithë ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin taksi nga dhe drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës.
 - b. Të heqë tabelën me shkrimin “Ndalohet taksi pa pasagjerë”, e cila ndalon dhënien e këtij shërbimi në shkelje të ligjit nr. 9121/2003.
- II. Masat e përkohshme duhet të zbatohen me marrjen dijeni të këtij vendimi.
- III. Masa e përkohshme merret për një periudhë kohore deri në përfundim të procedurës hetimore.
- IV. Në rast të moszbatimit të vendimit për masën e përkohshme të cituar në pikën (I) të këtij vendimi, ndërmarrja Tirana International Airport SHPK ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa (b) të ligjit nr. 9121/2003.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 988, Datë 24. 05. 2023

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË GRUPPO ZAFFIRO S.R.L. NGA SHOQËRITË EURIZON CAPITAL REAL ASSET S.G.R S.P.A. DHE SARAFIN S.P.A.”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.05. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Sarafin S.p.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Sarafin S.p.A.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Sarafin S.p.A.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Kuadër Investimi e propozuar”, palët në transaksion janë:

Blerësi 1: Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit italian me objekt aktiviteti menaxhimi i entiteteve të investimit kolektiv të kursimeve alternative dhe rreziqet përkatëse, si dhe administrimit dhe tregtimi i tyre; ofrimi i shërbimeve të Menaxhimit të Portofoleve; ofrimi i shërbimeve ndihmëse si dhe kryerja e veprimtarive përkatëse dhe

instrumentale, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi etj. Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. vepron në emër dhe për llogari të Eurizon Capital S.G.R S.p.A.

Eurizon Capital SGR S.p.A është shoqëria kontrolluese e Divizionit të Menaxhimit të Aseteve të Intesa SanPaolo Group, i cili është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i shoqërisë është ofrimi i veprimtarive bankare, veprimtarive financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit.

Blerësi 2: Sarafin S.p.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit italian, shoqëri holding, të ardhurat e të cilës i atribuohen linjave të mëposhtme të biznesit: 1. Menaxhimi i shtëpive të kujdesit për të moshuarit; 2. Ndërtimi (Tenderat); 3. Pasuri të Paluajtshme (qira dhe shitje); 4. Ushqim & Pije; 5. Shërbime të caktuara ndihmëse si kontabiliteti dhe listë-pagesat, rikuperimi i kredive dhe arkivimi i dokumenteve.

Sarafin S.p.A. nuk ka filiale dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Shitësi 1: Mittel S.p.A. është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit italian.

Shitësi 2: Blustone S.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit italian. Blustone S.r.l. zotërohet 100% nga Sarafin S.p.A.

z. G. R., person fizik, shtetas i huaj, [_____].

Shoqëria Target: Gruppo Zaffiro S.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit italian. Gruppo Zaffiro S.r.l. është një shoqëri holding, shoqëria mëmë e një grupi shoqërisht aktive në sektorin e menaxhimit operacional dhe zhvillimit të pasurive të paluajtshme të objekteve të mirëprirjes dhe / ose të kujdesit shëndetësor dhe / ose të mirëqenies sociale, të tilla si shtëpitë e strehuara dhe shtëpitë e pushimit për të moshuarit.

Gruppo Zaffiro S.r.l. zotërohet 60% nga Mittel S.p.A. dhe 40% nga Blustone S.r.l.

Gruppo Zaffiro S.r.l. nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Më datë 31 mars 2023, shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. (blerësi 1), Sarafin S.p.A. (blerësi 2), Mittel S.p.A., Blustone S.r.l. (shitësat) dhe z. G. R., kanë lidhur “Marrëveshje Kuadër Investimi e propozuar”.

Referuar “Marrëveshjes Kuadër Investimi e propozuar”, palët angazhohen në datën e ekzekutimit, të blejnë dhe të shesin aksionet e tregtuara më poshtë:

a) Investitori do të blejë nga Mittel S.p.A. 15% të kapitalit aksionar të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. dhe nga Blustone S.r.l. 40% të kapitalit aksionar të Gruppo Zaffiro S.r.l. Në këtë mënyrë pas shitjes së këtyre aksioneve, Investitori bëhet pronar i një aksioni në kapitalin aksionar të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l., që përfaqëson 55% të kapitalit aksionar të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l.

b) Sarafin S.p.A. do të blejë nga Mittel S.p.A. një pjesë të aksioneve Mittel, që përfaqëson 45% të kapitalit aksionar të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l.

“Draft - Marrëveshja e Aksionarëve” synon të rregullojë metodat dhe kushtet e bashkëpunimit ndërmjet palëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse si aksionarë të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. dhe përcakton rregullat për qeverisjen e shoqërisë, disiplinën në lidhje me qarkullimin e aksioneve të mbajtura në shoqëri etj.

Bazuar në këtë marrëveshje, palët bien dakord se shoqëria do të menaxhohet nga një Këshill Administrimi të përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë, 4 (katër) anëtarë do të zgjidhen nga Aksioneri A dhe 3 (tre) anëtarë do të zgjidhen nga Aksioneri B. Rezolutat e Këshillit të Administrimit të shoqërisë do të miratohen me shumicën ligjore. Rezolutat e Këshillit të Administrimit në lidhje me çështjet e listuara më poshtë, nuk mund të delegohen dhe duhet të miratohen me votën e favorshme të të paktën një prej administratorëve të Sarafin S.p.A. (Aksioneri B): a) modifikimi i planit të biznesit dhe miratimi/ndryshimi i planeve të reja të biznesit; miratimin dhe modifikimin e buxhetit vjetor; b) miratimin e planeve nxitëse të menaxhimit (përfshirë caktimin e menaxherëve individualë të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. ose instrumente të tjera financiare të kapitalit neto); c) punësimin dhe shkarkimin e administratorit financiar; d) blerjet / shitjet e aksioneve, bizneseve dhe / ose njësisve të biznesit dhe çdo investimi ose projekti në sektorin e referencës etj.

Vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të shoqërisë do të miratohen me shumicën ligjore. Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me çështjet e mëposhtme duhet të miratohen me votën e favorshme të Sarafin S.p.A.: a) zmadhimet e kapitalit aksionar; b) ndryshimet statutores; c) bashkimet, shkrirjet, transferimet dhe transformimet etj.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria target Gruppo Zaffiro S.r.l. do të zotërohet 55% nga Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe 45% nga Sarafin S.p.A.

Mbështetur në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimit midis ndërmarrjeve”, transaksioni i njoftuar përbën një përfitim kontrolli të përbashkët, mbi shoqërinë Gruppo Zaffiro S.r.l. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Sarafin S.p.A. dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu për ofrimin e shërbimeve të kujdesit dhe shëndetit social, nëpërmjet menaxhimit të shtëpive të kujdesit për të moshuar, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të përbashkët të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. nga shoqëria Eurizon Capital Real Asset SGR S.p.A. dhe shoqëria Sarafin S.p.A.

Pas transaksionit, Gruppo Zaffiro S.r.l. do të zotërohet 55% nga shoqëria Eurizon Capital Real Asset SGR S.p.A. dhe 45% nga shoqëria Sarafin S.p.A.

Eurizon Capital Real Asset SGR S.p.A. është një shoqëri që i përket Grupit Intesa Sanpaolo, një prej grupeve bankare kryesore italiane. Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, shoqëri që vepron në tregun e

shërbimeve bankare.

Sarafin S.p.A. dhe Gruppo Zaffiro S.r.l. nuk kanë filiale dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Gruppo Zaffiro S.r.l. nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A. dhe Sarafin S.p.A.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 989, Datë 08. 06.2023

“Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 874, datë 25.03.2022”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.06.2023 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 874, datë 25.03.2022.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi monitorimin e tregut të importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, në zbatim të VKK nr. 874, datë 25.03.2022, për ndërmarrjet AGROBLEND SHPK, MBM SHPK, dhe ÇAÇA SHPK”,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 874, datë 25.03.2022, vendosi:

- I. Gjobitjen e ndërmarrjes AGROBLEND SHPK në shumën 118,978,015 Lekë, për shkelje të nenit 4, pika 1, gërmat a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.
- II. Gjobitjen e ndërmarrjes MBM SHPK në shumën 66,088,573 Lekë, për shkelje të nenit 4, pika 1, gërmat a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.
- III. Gjobitjen e ndërmarrjes ÇAÇA SHPK në shumën 7,087,994 Lekë, për shkelje të nenit 4, pika 1, gërmat a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.
- IV. Monitorimin e tregut të importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.

I. Procedura e ndjekur:

2. Në zbatim të Vendimit të mësipërm, bazuar nenit 28, gërmat a) dhe d) të ligjit 9121/2003, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, ka filluar monitorimin e tregut të importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, në zbatim të VKK nr. 874, datë 25.03.2022, për ndërmarrjet AGROBLEND SHPK, MBM SHPK, dhe ÇAÇA SHPK.

3. VKK nr. 874, datë 25.03.2022 u është njoftuar ndërmarrjeve AGROBLEND SHPK, MBM SHPK, dhe ÇAÇA SHPK me anë të shkresës nr. 224/1 prot., datë 28.03.2022 “Njoftim vendimi”.
4. Në zbatim të VKK nr. 874/2022, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës përgatiti “Matricën e veprimeve për monitorimin e tregut të importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure, në respektim të VKK nr. 874, datë 25.03.2022”, e cila u miratua nga Sekretari i Përgjithshëm.
5. Me qëllim realizimin e monitorimit në zbatim të VKK nr. 874/2022, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, është kërkuar informacion, nga ndërmarrjet: AGROBLEND SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
6. Ndërmarrjet Agrobland SHPK, MBM SHPK dhe ÇAÇA SHPK janë përgjigjur në kohë dhe kanë paraqitur informacionin e kërkuar në përgjigje të kërkesave tona për informacion.
7. Nga administrimi dhe vlerësimi i informacionit të depozituar në kuadër të zbatimit të VKK nr. 874/2022, konstatohet si më poshtë vijon:
 - Plehu kimik DAP (Hidrogjenortofosfat diamoni) ka përdorim sezonal, kryesisht në 6-mujorin e parë të vitit dhe importi realizohet kryesisht në 3-mujorin e parë të vitit. Nga të dhënat e importit rezulton se burimi i furnizimit është i ndryshëm, ndërmarrja Agrobland SHPK realizon importe nga Rusia, ndërsa ndërmarrja MBM SHPK nga Tunisia. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve lidhur me çmimet mesatare mujore të shitjes të ndërmarrjeve Agrobland SHPK, MBM SHPK dhe ÇAÇA SHPK vërehet se për periudhën e monitorimit tetor 2021 - mars 2023, cmimet janë të ndryshme.
 - Plehu kimik Nitrat, importohet kryesisht gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit. Nga të dhënat e importit rezulton se burimi i furnizimit është i ndryshëm, ndërmarrjet Agrobland SHPK dhe ÇAÇA SHPK realizojnë importe nga Rusia por në periudha të ndryshme kohore, ndërsa ndërmarrja MBM SHPK realizon importe nga Greqia. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve lidhur me çmimet mesatare mujore të shitjes për ndërmarrjet Agrobland SHPK, MBM SHPK dhe ÇAÇA SHPK për periudhën e monitorimit tetor 2021 - mars 2023, cmimet janë të ndryshme midis njera-tjetrës.
 - Plehu kimik Ure importohet kryesisht gjatë gjithë periudhës të vitit. Nga të dhënat e importit rezulton se burimi i furnizimit është i ndryshëm, ndërmarrja Agrobland SHPK realizon importe nga Rusia, Greqia dhe Singapori, ndërmarrja MBM SHPK realizon importe nga Serbia, Gjeorgjia, Egjypti dhe Rusia, ndërsa ndërmarrja ÇAÇA SHPK nga Gjeorgjia dhe Turkmenistani. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve lidhur me çmimet mesatare mujore të shitjes për ndërmarrjet Agrobland SHPK, MBM SHPK dhe ÇAÇA SHPK, vërehet se kemi një rritje të përgjithshme të çmimeve, e cila reflekton rritjen e cmimit CIF, si pasojë e zhvillimeve ndërkombëtare (lufta në Ukrainë).

8. Për sa më sipër, gjatë periudhës së monitorimit, referuar të dhënave të importit dhe shitjes të plehrave kimikë Dap, Ure dhe Nitrat rezulton se sjellja e ndërmartjeve Agroblend SHPK, MBM SHPK dhe ÇAÇA SHPK nuk përbën shkelje në kuptim të nenit 4 te ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e monitorimit në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi të gjitha palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 990, Datë 08.06.2023

“MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT “MBI UDHËZIMET JOZYRTARE PËR SA I PËRKET ÇËSHTJEVE TË REJA OSE TË PAZGJIDHURA NË LIDHJE ME NENET 4 DHE 9 TË LIGJIT NR. 9121/2003 “PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS” PËR RASTE INDIVIDUALE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.06.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjdhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për raste individuale”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft-Udhëzimit “Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjdhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për raste individuale”,

VËREN SE :

1. Qëllimi i Udhëzimit mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjdhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për raste individuale, është ofrimi i sigurisë ndaj ndërmarrjeve mbi ligjshmërinë e veprimeve të tyre në lidhje me një marrëveshje ose praktikë që duan të zbatojnë, në rast paqartësie, sepse ato prezantojnë pyetje të reja ose të pazgjdhura për zbatimin e neneve 4 ose 9 të ligjit nr. 9121/2003.
2. Udhëzimi parashikon se Autoriteti mund të ofrojë udhëzime jozyrtare për ndërmarrjet nëse është në përputhje me prioritetet e tij të zbatimit të kuadrit ligjor për mbrojtjen e konkurrencës. Ai përcakton elementët të cilët do të merren në konsideratë për të vlerësuar nëse Autoriteti ka arsye të vlefshme për të dhënë qartësi mbi zbatimin e nenit 4 ose 9 të ligjit për marrëveshjen ose praktikën në fjalë, gjithashtu dhe rrethanat në të cilat Autoriteti nuk do të shqyrtojë një kërkesë për një letër udhëzuese.

3. Në Udhëzim sqarohen kushtet që duhet të përmbushë kërkesa e paraqitur nga një ndërmarrje ose disa ndërmarrje që kanë lidhur ose synojnë të hyjnë në një marrëveshje ose praktikë që mund të përfshihet në objektin e neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003, në mënyrë që të merret në shqyrtim nga Autoriteti.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Miratimin e Udhëzimit “Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” për raste individuale”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 991, Datë 08. 06. 2023

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË PROPOZUAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE EÓLICA CQN UNO SPA DHE EÓLICA CQN DOS SPA NGA SHOQËRIA EMPRESA ELÉCTRICA PILMAIQUÉN S.A.”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08. 06. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A..

Referuar “Marrëveshjeve për blerjen e aksioneve”, Draft Paraprak (për diskutim) të paraqitur, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A, është një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kilit, e angazhuar në prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë hidroelektrike. Shoqëria zotërohet në 99.43% të kuotave nga shoqëria Statkraft Chile Inversiones Eléctricas Limitada, shoqëri e grupit Statkraft, një shoqëri lider në prodhimin e energjisë hidrike në arenën ndërkombëtare dhe asaj të rinovueshme në Europë.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V; - *Statkraft Renewables Albania SHPK*, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt: Veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj, dhe - *Devoll Hydropower SHA*, shoqëri aksionare e themeluar, me objekt: Planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësisve prodhuese hidroelektrike në Luginën e Devollit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pala shitëse: Inversiones Bosquemar SpA, është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Kilit.

Shoqëria Target 1: Eólica CQN Uno SpA, është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Kilit, e angazhuar në zhvillimin e projekteve të energjisë përkatësisht nga era.

Shoqëria Target 2: Eólica CQN Dos SpA, është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Kilit, e angazhuar në zhvillimin e projekteve të energjisë përkatësisht nga era.

Shoqëritë target nuk janë prezente dhe nuk gjenerojnë xhiro në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Referuar dokumentacionit zyrtar të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, rezulton se: Blerësi Empresa Eléctrica Pilmaquén S.A është në proces negociimi të lidhjes së Marrëveshjes së blerjes së aksioneve me shitësin Inversiones Bosquemar SpA. Pritet që pas lidhjes së kësaj Marrëveshjeje, me përmbushjen e kushteve të mbylljes (të cilat do të përkufizohen në Marrëveshje), shitësi do të shesë të gjitha kuotat e zotëruara në kapitalin e shoqërive target, Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA.

Transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Në zbatim të nenit 60 pika 1 të ligjit 9121/2003, pala njoftuese ka kërkuar Autorizimin e Përqendrimit të Përkohshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët, pasi procesi i pritjes së miratimit të transaksionit nga Autoriteti i Konkurrencës shkakton vonesa, të cilat do të kishin pasoja të pariparueshme për lidhjen e kësaj marrëveshjeje.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e propozuar të aksioneve të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaquén S.A, e cila do të bëhet efektive me nënshkrimin e Marrëveshjes dhe plotësimit të Kushteve Paraprake. Shoqëritë target nuk janë prezente dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri. Pas vendosjes në operim, projektet do të kenë ndikim vetëm në tregun e energjisë së Kilit.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Përqendrimi i propozuar nuk pritet të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar duket se nuk do të sjellë ndryshim dhe duket se nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

Bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e

palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Autoriteti i Konkurrencës gjykon të nevojshëm dhënien e autorizimit të përqendrimit të përkohshëm deri në depozitimin e marrëveshjes së nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe të nenit 60 pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përkohësisht përqendrimit e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Eólica CQN Uno SpA dhe Eólica CQN Dos SpA nga shoqëria Empresa Eléctrica Pilmaiquén S.A.
- II.** Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
- III.** Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- IV.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 992, Datë 08. 06. 2023

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BASHKIMIT ME PËRTHITHJE TË SHOQËRISË GEGA OIL SHA NGA SHOQËRIA GENKLAUDIS SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08. 06. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Autoriteti i Konkurrencës, mbështetur në informacionin e administruar gjatë procedurave hetimore në tregun e karburanteve, si dhe pas verifikimit të ekstraktit historik të shoqërive GEGA OIL GROUP SHA dhe GEGA OIL SHA, konstatoi se, në datë 02.03.2021 është nënshkruar marrëveshja e bashkimit me përthithje mes shoqërive GENKLAUDIS SHA (shoqëria përthithëse) dhe GEGA OIL SHA (shoqëria e përthithur).

Në zbatim të nenit 10, 12 dhe 53 të ligjit nr. 9121/2003, ju kërkua shoqërisë GEGA OIL GROUP SHA depozitimi i dokumentacionit të përcaktuar në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” dhe fillimin e procedurave të kontrollit të përqendrimeve.

Referuar dokumentit “Marrëveshja e Bashkimit me Përthithje midis shoqërive GENKLAUDIS SHA dhe GEGA OIL SHA”, të lidhur më datë 02 mars 2021, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: GENKLAUDIS SHA (sot GEGA OIL GROUP SHA) është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregtim me shumicë dhe pakicë i naftës dhe nënprodukteve të saj, gazit dhe nënprodukteve të tij, nënprodukteve përfshirë ato bio, si dhe lëndëve djegëse. Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndërtuese, ndërtime te objekteve të ndryshme industriale e civile, prodhim të inerteve dhe materiale ndërtimi, financime që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë si dhe çdo veprimtari tjetër që nuk bie në kundërshtim me ligjin.

Shoqëria GENKLAUDIS SHA zotërohet 100% nga z. Paulin Gega.

Pala shitëse: z. Klaudio Gega dhe z. Genc Gega janë persona fizikë, shtetas shqiptar, të cilët zotërojnë nga 50% të aksioneve të shoqërisë target.

Shoqëria target: GEGA OIL SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: tregtim me shumicë dhe pakicë i naftës dhe nënprodukteve të saj, gazit dhe nënprodukteve të tij, nënprodukteve përfshirë ato bio, si dhe lëndëve djegëse. Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndërtuese, ndërtime te objekteve të ndryshme industriale e civile, prodhim të inerteve dhe materiale ndërtimi, financime që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë si dhe çdo veprimtari tjetër që nuk bie në kundërshtim me ligjin.

II. Përqendrimi

Më datë 21 janar 2021 shoqëritë GENKLAUDIS SHA dhe GEGA OIL SHA, kanë analizuar kushtet dhe mundësitë e bashkimit të dy shoqërive nëpërmjet përthithjes dhe për këtë arsye pas mbledhjeve përkatëse të dy shoqërive, u autorizua fillimi i procedurave të bashkimit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në draft marrëveshjen e bashkimit.

Më datë 02 mars 2021, ndërmjet shoqërive GENKLAUDIS SHA (Shoqëria përthithëse) dhe GEGA OIL SHA (Shoqëria e përthithur) është lidhur Marrëveshja e Bashkimit më Përthithje.

Referuar kësaj marrëveshjeje, GEGA OIL SHA do të transferojë tërësisht të gjitha aktivitetet dhe pasivitetet e saj dhe ekzistenca më vete e GEGA OIL SHA do të përfundojë. GENKLAUDIS SHA do të jetë shoqëria përthithëse, e cila sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar quhet GEGA OIL GROUP SHA.

Struktura e zotërimit të kapitalit pas bashkimit me përthithje të shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA është: Z. Paulin Gega 82%, Z. Klaudio Gega 9% dhe Z. Genc Gega 9%.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i bashkimit me përthithje i shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes me shumicë të karburanteve, i ndarë në dy nëntregje: - nëntregu i produktit benzinë; - nëntregu i produktit naftë, dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i bashkimit me përthithje të shoqërisë Genklaudis SHA dhe Gega Oil SHA përbën një

përqendrim horizontal, pasi palët pjesëmarrjeve në transaksion janë konkurrentë të afërt që veprojnë në të njëjtin treg përkatës.

Procedura e kontrollit të përqendrimit ka qenë një vlerësim ex-post dhe tregu i shitjes me shumicë të karburanteve ka reflektuar *de facto*, efektet e transaksionit të bashkimit mes konkurrenteve në të njëjtin treg.

Mbështetur mbi të dhënat e kërkuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe përcaktimit të strukturës së tregjeve, rezultoi se indeksi i përqendrimit Herfindahl-Hirschman (HHI) për produktin naftë për vitin 2020 paraqitet në vlerën XXX dhe për vitin 2021 në vlerën XXX, ndërsa për produktin benzinë në vlerën XXX për vitin 2020 dhe në vlerën XXX për vitin 2021.

Për produktin naftë, tregu paraqitet mesatarisht i përqendruar, ku pjesa e tregut për tre dhe pesë konkurrentet kryesor (CR3 dhe CR5) është përkatësisht në vlerat XX% dhe XX% për vitin 2021. Për produktin benzinë, tregu paraqitet mesatarisht i përqendruar, ku pjesa e tregut e tre dhe pesë konkurrentëve kryesor (CR3 dhe CR5) është përkatësisht vlerat XX% dhe XX% për vitin 2021.

Në tregun e shitjes së naftës u konstatua se Genklaudis SHA zotëron XX% të tregut dhe Gega Oil SHA vetëm XX% të tij në vitin 2020. Pjesa e kombinuar e tregut e dy ndërmarrjeve Genklaudis SHA dhe Gega Oil SHA rezulton në vlerën XX% për 2020 dhe shkon në XX% në vitin 2021.

Në tregun e shitjes së benzinës, u konstatua që ndërmarrja Gega Oil SHA nuk ka realizuar zhdoganime.

Përqendrimi ka krijuar mbivendosje midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar në tregun e naftës dhe benzinës, por pa efekte të ndjeshme në strukturën e tregut për shkak të pjesës së vogël të tregut të ndërmarrjes së përthithur.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 993, Datë 08. 06. 2023

“PËR VENDOSJE GJOBE NDAJ SHOQËRISË GEGA OIL GROUP SHA, PËR MOS NJOFTIMIN BRENDA AFATIT TË PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BASHKIMIT ME PËRTHITHJE TË SHOQËRISË GEGA OIL SHA NGA SHOQËRIA GENKLAUDIS SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08. 06. 2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i sjelljes së shoqërisë Gega Oil Group SHA për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë Gega Oil SHA nga shoqëria Genklaudis SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, nenet 53-64 dhe neni 73 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm; raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA si dhe relacionit “Mbi llogaritjen e gjobës për shoqërinë Gega Oil Group SHA”,

VËREN SE :

I. Procedura

Autoriteti i Konkurrencës, mbështetur në informacionin e administruar gjatë procedurave hetimore në tregun e karburanteve, si dhe pas verifikimit të ekstraktit historik të shoqërive GEGA OIL GROUP SHA dhe GEGA OIL SHA, konstatoi se, në datë 02.03.2021 është nënshkruar marrëveshja e bashkimit me përthithje mes shoqërive GENKLAUDIS SHA (shoqëria përthithëse) dhe GEGA OIL SHA (shoqëria e përthithur).

Në zbatim të nenit 10, 12 dhe 53 të ligjit nr. 9121/2003, me shkresën nr. 62 prot.i AK, datë 23.01.2023 “Mbi fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimit.”, ju kërkua shoqërisë GEGA OIL GROUP SHA depozitimi i dokumentacionit të përcaktuar në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” dhe fillimin e procedurave të kontrollit të përqendrimeve.

Me shkresën nr. 62/1 prot. i AK, datë 08.02.2023 “Kthim përgjigje shkresës tuaj nr. 62 prot., datë

23.01.2023” dhe shkresën nr. 62/2 prot.i AK, datë 16.03.2023, shoqëria GEGA OIL GROUP SHA depozitoi dokumentacionin e dosjes së njoftimit të përqendrimit.

Më datë 02 mars 2021, ndërmjet shoqërive GENKLAUDIS SHA (Shoqëria përthithëse) dhe GEGA OIL SHA (Shoqëria e përthithur) është lidhur Marrëveshja e Bashkimit më Përthithje.

Referuar kësaj marrëveshjeje, GEGA OIL SHA ka transferuar tërësisht të gjitha aktivitetet dhe pasivitetet e saj tek shoqëria GENKLAUDIS SHA dhe shoqëria përthithëse është quajtur GEGA OIL GROUP SHA.

Struktura e zotërimit të kapitalit pas bashkimit me përthithje të shoqërisë GEGA OIL GROUP SHA është: Z. Paulin Gega 82%, Z. Klaudio Gega 9% dhe Z. Genc Gega 9%.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni përbënte një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë ishte objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

II. Njoftimi i përqendrimit në shkelje të afatit ligjor

Bazuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, një përqendrim duhet të njoftohet pranë Autoritetit të Konkurrencës brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes.

Në zbatim të nenit 53 të ligjit, kanë detyrimin për njoftim: a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim; b) ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera; c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 3 të nenit 10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.

Në rastin e bashkimit me përthithje i shoqërisë GEGA OIL SHA nga shoqëria GENKLAUDIS SHA, detyrimin për njoftim e kanë të dyja shoqëritë e përfshira në transaksion.

Referuar dokumentacionit të depozituar konstatohet se transaksioni nuk është njoftuar brenda afatit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Nga vlerësimi i dokumentacionit, Komisioni i Konkurrencës evidentoi faktin se shoqëritë pjesëmarrëse në transaksion (Genklaudis SHA dhe Gega Oil SHA) kanë kryer shkeljen administrative në kuptim të nenit 73 të ligjit nr. 9121/2003, e cila konsiderohet si shkelje e lehtë.

Shoqëritë nuk rezultojnë të kenë kryer shkelje të mëparshme në kundërshtim me ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Pas vlerësimit të efekteve që ka sjellë transaksioni në tregun përkatës, u konstatua mbivendosje midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar në tregun e naftës dhe benzinës, por pa efekte të ndjeshme në strukturën e tregut përkatës për shkak të pjesës së vogël të tregut të ndërmarrjes së përthithur.

Për mos respektim të afatit të përcaktuar, bazuar në nenin 73, pika 1, germa dh) e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendos gjobë në masën jo më shumë se 1% e xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet apo grupimet e ndërmarrjeve nëse nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij Ligji.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe neni 73, pika 1, germa dh të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Vendosijen e gjobës mbi shoqërinë GEGA OIL GROUP SHA, në masën XXX ([....]) lekë, për mos njoftimin brenda afatit të përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë Gega Oil SHA nga shoqëria Genklaudis SHA.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

2023

VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2023
BULETINI ZYRTAR

